Yurdaydın, Hüseyin G.: “Matrakçı Nasuh”, **TDV İslâm Ansiklopedisi**, TDV İslâm Araştırmaları Merkezi, 2003, C.28, s. 143-145

# REFLEKSIONET PSIKOTERAPEUTIKE TË SHTËPISË SË SHËNDETIT TË XHAMISË SULEJMANIJE NË KUJDESIN E SHËNDETIT MENDOR TË SHOQËRISË

Besar Rufati<sup>1</sup>

**Abstrakt:** *Mjekësia e hershme kishte mungesë të referencave, teorive dhe hipotezave dhe ishte gjithashtu e distancuar nga zhvillimi teknologjik, mirëpo praktika e saj formuloi koncepte dhe metoda që mbetën koherente. Për dallim nga sot, këto metoda për bazë kishin mjekësinë alternative dhe jo medikamentet e ndryshme sintetike të mbushura me efekte anësore. Ato për trajtime dhe problematika shëndetësore përdorën elementet natyrore, me të cilat arritën jo vetëm që të shërojnë epidemi dhe plagë, por edhe të përmirësonin problematika shëndetësore mendore, që sot shihen si të pashërueshme. Nëse këto trajtime kishin ndikim në përmirësim të gjendjes mendore, me ekspozim të elementeve natyrore, atëherë aspektet mjekësore i japin dritë jeshile përdorimit të këtyre teknikave duke i plotësuar shpjegimin fiziologjik dhe ndryshimin e mundshëm hormonal. Punimi jonë do të argumentojë këto praktika, duke sjellë shembuj dhe studime që pohojnë praktikisht ndikimin fiziologjik të elementeve natyrore, gjegjësisht ujit dhe reliefit.*

**Fjalë kyçe:** *Darüşşifa, xhamia Sulejmanije, psikoterapia, uji, dielli.*

## 1. Hyrje

Historia botërore kaloi në shumë periudha të ndryshme dhe përjetoi ndryshime nga dimensionet e llojllojshme. Këto ndryshime bota i fitoi nga përpjekjet njerëzore, të cilat në çdo kohë u motivuan nga nevojat shoqërore. Ndryshimet me ndikim më të madh në histori ishin ato që shoqërisë i ofruan përmbushje nga çdo lëmë, që realisht kjo i mundësoi njeriut të hapëronte drejt diturisë së njohjes së vetvetes.

Me dekada të tëra pas rënies së Perandorisë Romake, zhvillimi shkencor në Evropën Perëndimore u shua dhe hasi në një pushim pothuajse të përjetshëm, ndërsa me zhvillimin e botës myslimane, u përjetua një epokë e quajtur “Periudha e Artë” (Golden Age), periudhë kjo që fillet e saj i pati nga shekulli VII e deri në shekullin XVI. Gjatë kësaj periudhe, studiues të besimeve dhe kulturave të ndryshme e vazhduan ndërtimin dhe zhvillimin shkencor nga mësimet e trashëguara nga Egjipti i lashtë, Mesopotamia antike, Persia, Kina, India, si dhe grekët dhe romakët, kështu duke ndihmuar dhe lehtësuar rrugën për hapjen e renesancës evropiane.

<sup>1</sup> Student në universitetin “Qirili dhe Metodi”- Shkup, drejtimi Bioinxhinier i Laboratoris.

Kësaj periudhe të zhvillimit shkencor nuk i munguan edhe risitë mjekësore. Myslimanët gjatë kësaj periudhe arritën të vendosin në funksion për herë të parë një spital me organizim administrativ, që trajtonte pacientë të ndryshëm pa dallim race, nacionaliteti apo kategorie sociale, e gjitha kjo me një shërbim falas. Spitalet islame filluan të paraqiteshin në shekullin XVIII në qytetin e Bagdadit, mirëpo spitali i parë që pati funksion dhe organizim në nivel administrativ ishte në qytetin e Kajros, i ndërtuar ndërmjet viteve 827 dhe 874, i quajtur “Spitali Ahmed ibn Tulun”.

Me formimin e principatave të ndryshme në territorin e Anadollit, që nga shekulli XIII e deri në shekullin XV, u zhvilluan qytetërime që edhe pse dallonin për nga suazat politike, ato realisht kishin kulturë, mendime dhe botëkuptime me themele të përbashkëta.

Popujt turq që arritën të vendoseshin në Anadoll në shekullin XI, sunduan ato territore për më shumë se 200 vjet në udhëheqjen e Selçukëve të Anadollit dhe principatave anadollake. Në fillim ato konsideroheshin si pjesë ushtarake e pakontestueshme e mbretërisë së selçukëve që vepronin në kahun e territoreve perëndimore, por më vonë arritën që të pavarësoheshin duke formuar identitetin dhe shtetin e tyre.

Mjekësia klasike osmane u zhvillua falë traditave mjekësore të Selçukëve të Anadollit dhe shkencëtarëve e studiuesve që vinin nga qendrat e atëhershme kulturore si Egjipti, Siria, Irani dhe Turkestani. Në përgjithësi, mjekësia osmane në periudhën klasike, referencë të problematikave shëndetësore kishte njohuritë islame.<sup>2</sup>

Historia e mjekësisë osmane gjatë historisë së zhvillimit të saj kaloi në tri periudha, që dalloheshin nga njëra-tjetra për nga burimet e informacioneve mjekësore. Ato periudha ishin:

- **Periudha e principatave** kishte në përbërje një bashkësi të funksionimit mjekësor në nivel të principatave dhe çdo zhvillim mjekësor mjaftohej vetëm me aplikim të brendshëm e jo në nivel rajonal.
- **Periudha klasike** (1450 – 1826) është periudhë në të cilën të gjitha teoritë dhe metodat mjekësore bazoheshin në mësimet dhe informacionet e trashëguara islame. Në këtë periudhë, shërbimi mjekësor fillon të ofrohet në nivel

---

<sup>2</sup> Ali Haydar Bayat, **Tip Tarihi**, Zeytinburnu Bel.Kültür Yay. Stamboll, 2016, fq. 295..

institucional me hapjen e spitalit të parë që funksiononte nën konceptin e *darişşifa-së*, i ndërtuar nga udhëheqësi i asaj kohe Jëlldërëm Bajaziti, në vitet 1399-1400. Mjeku dhe kirurgu më i famshëm i kësaj kohe ishte Sherafeddin Sabunxhuollu (1386 – 1470), me veprën e tij të famshme të parë që formulohet në gjuhën osmane (turke), e titulluar “Kitâbü’l-Cerrâhiyyetü’l-Hâniyye”, libër ky që pjesërisht ishte përkthyer nga gjuha arabe, por gjithashtu përmbante përvojat dhe dorëshkrimet e vetë përkthyesit. Kjo periudhë vazhdoi me hapjen e shumë spitaleve të tjera.<sup>3</sup>

- **Periudha e modernizimit** (pas vitit 1826), në të cilën ndodh një tranzicion në referencat mjekësore, ku metodat dhe terapitë shëndetësore marrin formë nga teoritë dhe burimet evropiane. Në këtë periudhë fillon iniciativa për edukim mjekësor në shtetet evropiane.

## 2. Kompleksi i xhamisë Sulejmanije

Shekulli XVI, periudha më stabile dhe më e fuqishme e perandorisë osmane, krahas institucioneve dhe vatrave të shumta që ofronin shërbime mjekësore, gjithashtu karakterizohej edhe me objekte higjienike si banjo publike, shatërvanë, sisteme ujitëse etj. Një nga monumentet më të rëndësishme të asaj kohe ishte edhe kompleksi i xhamisë Sulejmanije, kompleks ky që përbëhej nga një sërë objektesh me shërbim social dhe mjekësor. Kompleksi i xhamisë është ndërtuar në qytetin e Stambollit, i projektuar nga arkitekti i famshëm Mimar Sinan, dhe në aspektin arkitekturor, paraqet një nga veprat më të rëndësishme të shekullit XVII dhe po ashtu gjithë Perandorisë Osmane.<sup>4</sup>

Kompleksi, i cili u ndërtua nga Sulltan Sulejmani, në vendin e ish-Pallatit të Vjetër, përfshin një sipërfaqe të pjerrët prej 63.500 metrash katror dhe përbëhet nga pesë medrese, shkolla fillore, shkolla për mësimin e thënieve profetike, spital me departamente të ndryshme, medrese mjekësore, dârûhane (farmaci), kuzhinë, bibliotekë, si dhe objektin kryesor, xhaminë në qendër të kompleksit. Xhamia

<sup>3</sup> Ali Haydar Bayat, **Tip Tarihi**, Zeytinburnu Bel.Kültür Yay. Stamboll, 2016, fq. 295-296.

<sup>4</sup> Të shihet: Abdullah Kilic, **Anadolu Selçuklu ve Osmanli Sefkat Abideleri**, Mediapark, Stamboll, 2012.

gjithashtu përmban shatërvan, banjo, bodrume, hamam dhe 36 dyqane. Ndërtimi i kompleksit filloi në vitin 1550 dhe përfundoi në vitin 1557.<sup>5</sup>

## 2.1. Plani urbanistik i xhamisë

Kompleksi është i shtruar në një truall jo të rrafshët të tokës, në përputhje me topografinë, e cila është e tarracuar dhe e pabarabartë. Kompleksi ndodhet në vendin e pallatit të parë osman, i njohur si Pallati i Vjetër, në një nga shtatë kodrat e Stambollit në drejtim të bregut të “Brrit të Artë”, sipër lagjes *Eminönü*. Kjo pjesë është një nga pikat më të larta në qytetin e vjetër të Stambollit dhe zotëron pamje jashtëzakonisht të bukur.

## 2.2. Xhamia

Xhamia paraqet kulminacionin e stilit osman që ishte zhvilluar në shekullin e ndërtimit të xhamisë. Përmban një sallë madhështore lutjesh të cilën e mbulojnë një sërë kubesh dhe një binë të madhe të hapur që i paraprin sallës së lutjeve në anën veriperëndimore. Hapja dhe integriteti në arkitekturën e brendshme të xhamisë Sulejmanije forcojnë më tej impulsin e ndjeshëm dhe madhështor të vendit.<sup>6</sup>

Xhamia gjithashtu dallohet për nga ndjeshmëria shpirtërore, nga jeta e brendshme dhe vdekja, rendi i shenjtë dhe botëror, ai fizik dhe shpirtëror, që realisht është një fushë që balancon realitetet e brendshme dhe të jashtme. E gjithë kjo shprehet jo vetëm nga cilësitë vizuale të arkitekturës, por edhe nga artet e ndryshme brenda xhamisë, ku secila adreson shqisat për ndjenja të ndryshme.

Dritaret me ngjyra të ndryshme, zbukurimet nga druri, pozicionimi i gurëve dhe mermerit, qilimat, dekorimi i pllakave me shkrime të shenjta nga Kurani apo pikturimi i luleve, të gjitha këto, janë krijuar me qëllimin e ndërtimit të një mjedisi të ndjeshmërisë.

## 2.3. Medresetë

Pesë medresetë<sup>7</sup> kushtuar ligjit islam marrin pothuajse të njëjtin plan, bazuar në formën tradicionale të këtij lloji të ndërtimit: një oborr qendror i rrethuar nga një pasazh me kupola të vogla rreth perimetrit të ndërtesës; në anën jugperëndimore të

<sup>5</sup> Ali Haydar Bayat, **Tip Tarihi**, Zeytinburnu Bel.Kültür Yay. Stamboll, 2016, fq. 295.

<sup>6</sup> Ibrahim Zeyd Gerçik, **Her Dem Guçlu**, Yonetim, Stamboll, 2009, fq. 65.

<sup>7</sup> Numri i medreseve i referohet 5 kushteve të Islamit.

oborreve, një dhomë me kupolë më të madhe që shërbente si sallë studimi (dershane); gjithashtu, përsikaj medreseve për mësimin e shkencave islame, kompleksi i xhamisë korrespondonte edhe me medrese për mësimin e shkencave mjekësore.<sup>8</sup>

Në këto medrese, fillimisht nxënësit mësonin elementet bazë të mësimëve shkencore, pastaj me kalimin e kohës, ata u nënshtroheshin edhe informacioneve nga shkencat islame, matematikë dhe astronomi. Gjithashtu, për studentët që vijonin mësimin në këto medrese kishte dhoma specifike për fjetje dhe mësim, mirëpo ajo që e bën të veçantë këtë projektim është se dhomat e studentëve dhe profesorëve ishin afër njëra-tjetrës, gjë që kishte për qëllim shpeshimin e kontakteve mes tyre, në mënyrë që nxënësit të përfitonin nga këshillat dhe pyetjet që do t'ua parashtronin mësuesve.

Kompleksi i xhamisë Sulejmanije në dispozicion kishte edhe medresenë mjekësore, shërbimi dhe ekzistenca e së cilës kishte rol jetësor. Kjo medrese ishte e para që u ndërtua nga ana e shtetit osman, në vitin 1555. Para kësaj, të gjitha njohuritë mjekësore merreshin në *darüşşifa*, derisa kompleksi i xhamisë e veçoi me objekt të veçantë. Në këtë medrese vijonin studimet gjithsej tetë studentë që fitonin njohuritë nga katër profesorë. Si në çdo medrese osmane, edhe te medreseja mjekësore e Sulejmanijes mësimet dhe referencat e njohurive mjekësore ishin të trashëguara nga studiues dhe dijetarë të perandorive të mëhershme anadollake.<sup>9</sup>

Po ashtu, funksionin e medresesë mjekësore e plotësonte edhe prania e afërt e *darüşşifa-së*, ku arritën të krijonin një sistem që do të kishte edhe zbatim bashkëkohorë që studentët pjesën teorike ta vijonin te medreseja e më pastaj pjesën praktike ta vazhdonin te *darüşşifa-ja*.

Me qëllimin e nxjerrjes së kuadrove profesionale, studentët që vijonin studimet mjekësore duhej që paraprakisht të tregonin sukses në mësimet e tyre të shkollës fillore dhe të mesme.<sup>10</sup>

Sidoqoftë, një tipar i rëndësishëm i studentëve osmanë në shkencat mjekësore ishte se ata paraprakisht ishin të ditur në shkencat fetare, sepse, para se të vinin në

<sup>8</sup> Necipoğlu, Gülru. *The Age of Sinan: Architectural Culture in the Ottoman Empire*. Reaktion Books, London, 2005, fq. 169.

<sup>9</sup> Po aty.

<sup>10</sup> Ayten Altınbas, *Osmanlılarda Tıp Egetimi, Osmanlı Devleti'nin Sağlık Hizmetleri Sempozyumu*, Ankara, 2000, fq.89.



medresenë mjekësore, ata kalonin shkollimin fillestar me edukimin klasik të medresesë. Studentët që studionin në medresenë mjekësore të xhamisë Sulejmanije ishin gjithashtu me bursë dhe kishin shumë të drejta sociale. Përveçse u jepeshin të holla ditore, ata qëndronin në konviktin e medresesë dhe hanin dy vakte në ditë nga kuzhinat e kompleksit.

#### 2.4. Objektet që ofronin shërbime publike

Kompleksi i xhamisë asnjëherë nuk u mjaftua vetëm si një vend ku besimtarët mund të kryenin ritualet fetare, por gjithashtu qëllimi ishte që shoqërisë t'ia plotësonte të gjitha nevojat, qoftë nga aspekti shpirtëror, por edhe ai fizik. Kompleksi, krahas medreseve, kishte spital, që njëj me emrin *darüçşifa*, i cili u ofronte shërbim të gjithë njerëzve, qofshin ata myslimanë apo jomyslimanë, të varfër apo të pasur.

Po ashtu, në *darüçşifa* mjekët nuk përcaktoheshin nga përkatësia fetare, por përgatitja profesionale. Pjesë përbërëse e shumë komplekseve të këtilla ishte edhe kuzhina që quhej *imarethane*. Funkzioni i kësaj kuzhine ishte që të siguronte ushqim për nxënësit dhe mësuesit e medreseve, mjekët dhe pacientët e spitalit, personelin e xhamisë, mysafirët e kompleksit, si dhe për çdo të varfër që kishte nevojë.

E gjithë kjo ishte falas dhe shpenzimet mbulohehin nga pushteti. Kompleksi kishte gjithashtu pjesë speciale për pritjen e mysafirëve apo udhëtarëve (*tabhane*). Aty u mundësohej vendqëndrim dhe plotësim i nevojave që ishin të kërkueshme për udhëtim. Ajo që e plotësonte shërbimin e kompleksit ishte edhe prania e depos për mallra dhe hamami (banjë turke).<sup>11</sup>

### 3. *Darüçşifa*-ja

*Darüçşifa-të*<sup>12</sup> funksionin e tyre si institucion e filluan me civilizimin e hershëm islam duke e përbushur në tërësi funksionin e një spitali që ofronte terapi dhe medikamente për gjitha problemet shëndetësore që realisht ishin paraqitur në shoqëri, kështu, duke i plotësuar nevojat shoqërore në nivel institucional. Gjatë periudhave kohore, *darüçşifa-të* arritën të kryenin funksionin e njëjtë edhe gjatë ndërrimit të perandorive, si ajo e selçukëve dhe osmanëve, ndërsa me përfundimin e

<sup>11</sup> Ibrahim Zeyd Gerçik, **Her Dem Guçlu**, Yonetim, Stamboll, 2009, fq.35-40.

<sup>12</sup> Nga tr. "Shtëpia e shëndetit".

kësaj të fundit, Perandorisë Osmane, përfundoi edhe funksioni institucional i *darüşşifa-ve*.

### 3.1. Koncepti teorik dhe funksional i *darüşşifa-së*

Përgjatë historisë, ato kishin emërtime të ndryshme. Kryesisht, këto institucione thirreshin si “*darüşşifa*”, që në gjuhën turke kanë kuptimin “shtëpia e shëndetit”, “dera e shëndetit” apo “vendi i shërimit”. Ato gjithashtu kishin edhe emërtime të tjera që ishin nga supozimet shoqërore, por edhe të ndikuara nga lokacioni gjeografik, si *bîmarhâne*, *mâristan*, *dârülmerza*, *dârülâfiye* dhe *dârüssihha*.<sup>13</sup>

Këtë emërtim *darüşşifa-të* e fituan nga shërbimet koherente që i ofruan, shërbime këto që nuk u mjaftuan vetëm me trajtimin e pacientëve që shprehnin ndonjë pakënaqësi shëndetësore, por edhe me funksione të tjera që ofronin shërbime mjekësore të ndryshme. Vlen të theksohet se *darüşşifa-të* vinin si pjesë përbërëse e komplekseve të ndërtuara nga perandoritë që u vendosën në pjesën e Anadollit<sup>14</sup>, komplekse këto që nuk vepronin vetëm në aspektin fetar, si xhamitë apo medresetë, por gjithashtu ofronin edhe shërbime të tjera sociale, si arsimimin fillor dhe të mesëm, arsimim mjekësor, ndihmë dhe strehim për të varfërit, spitale me spektër të gjërë të shërbimeve, departamente të veçanta për trajtimin e pacientëve me retardim mental, barnatore e të tjera.

*Darüşşifa-të* në historinë e qytetërimit osman ishin pjesë përbërëse e çdo qyteti që realisht korrespondonte me numër të madh të banorëve, ku edhe nevoja për këtë institucion ishte në proporcion me madhësinë dhe kërkesat shoqërore. Qytetet e para ku u ndërtuan *darüşşifa-të* ishin qytetet si Bursa, Edirneja, Stambolli. Direktivat për ndërtimin e *darüşşifa-ve* kryesisht vinin nga sulltanët apo pashallarët, që i ndërtonin në emër të nënave apo vajzave të tyre, por gjithmonë të motivuar nga bindjet fetare islame, se shërbimi më i mirë në shoqëri është dobishmëria ndaj “njerëzve” dhe se përmbushja e funksioneve shtetërore kalonte vetëm nga kjo rrugë. Po ashtu, *darüşşifa-të* në shoqëri kishin statusin si vakëfe<sup>15</sup> që kategorikisht ndalonte

<sup>13</sup> Abdullah Kilic, *Anadolu Selçuklu ve Osmanlı Sefkat Abideleri*, Mediapark, Stamboll, 2012. fq. 42

<sup>14</sup> Pjesa aziatike e republikës së sotme të Turqisë.

<sup>15</sup> Pasuri e patundshme, që ishte pronë e një xhamie, e një kisha, e një teqeje a e një manastiri.

përfitimin personal nga shërbimet e këtyre objekteve, por funksioni dhe shërbimet gjithmonë do të ishin për qëllime humanitare.

Funksioni qindravjeçar i *darüşşifa-së* dhe shërbimi që ofroi ky spital drejt qytetarëve u zhvillua nën parimet: “Ofrim i shërbimeve të barabarta për të gjithë njerëzit, qofshin myslimanë apo jomyslimanë; mjekët të punësohen në bazë të kapacitetit të tyre profesional, e jo në bazë të përkatësisë fetare; personeli të jetë në gjendje që t’ua kryejnë nevojat pacientëve që vijnë në vizitë dhe atyre që qëndrojnë; si dhe, në rast nevoje, shërbimi mjekësor të bëhet edhe nëpër shtëpi.”<sup>16</sup>

Historia e Perandorisë Osmane korrespondonte me shumë *darüşşifa* të ndryshme, mirëpo ajo që e bëri *darüşşifa-në* e xhamisë Sulejmanije të dallohet nga *darüşşifa-të* e tjera është se ky spital, përveç departamenteve për trajtim të përgjithshëm, gjithashtu kishte pjesë të veçantë për trajtimin e pacientëve me probleme psikike, konkretisht departament të psikoterapisë.

### 3.2. Struktura e *darüşşifa-së*

Funksionimi strukturor i *darüşşifa-së* kryesisht përbëhej prej dy kateve që dalloheshin për nga shërbimi:

- Kati i parë: në këtë pjesë gjendej personeli i *darüşşifa-së*, si mjekët, kirurgët, infermierët, farmacistët dhe personat e autorizuar që kujdeseshin për pastërtinë e objektit të *darüşşifa-së*.
- Kati i dytë: me një korridor të gjatë, i përbërë nga dhoma të shumta në pjesën e djathtë, dhe i mbuluar me kube të vogla, gjendej pjesa në të cilën qëndronin pacientët. Këto dhoma dalloheshin në funksion për nga problemi i pacientit, sepse pacientët me probleme psikoterapeutike kishin pjesë të veçantë.<sup>17</sup>

Gjithashtu, nga shërbimet që ka ofruar *darüşşifa-ja* në aspektin e departamenteve të *darüşşifa-së*, dallojmë pjesën për mjekët dhe personelin shëndetësor, dhomat në katin e dytë për pacientët, personelin për pacientët e psikiatrisë, kuzhinën për personelin mjekësor, kuzhinën për pacientët, si dhe pjesën e barnatores.

<sup>16</sup> Ibrahim Zeyd Gerçik, **Her Dem Guçlu**, Yonetim, Stamboll, 2009, fq.42.

<sup>17</sup> Të shihet: Celal Mustafa, Seyyid Lokman, **Hunername**, Yapı Kredi - Doğan Kardeş, Stamboll, 1969.

Veçoritë parësore të *darüşşifasë* nuk u mjaftuan vetëm me departamentin e psikoterapisë, por gjithashtu, projektimi dhe struktura objektive i hapën derën funksionimit edhe më të suksesshëm të aspekteve mjekësore e po ashtu, edhe një fryme të re në metodat shëndetësore. Realisht, arkitekti që realizoi objektin u mundua që metodat shëndetësore të mos mjaftohen vetëm nga medikamentet e gatshme të terapisë mjekësore, por gjithashtu të shfrytëzohen elementet natyrore që kanë ndikim në lehtësimin e metodave.<sup>18</sup> Këtu rol të veçantë zë pozicioni topografik i *darüşşifa-së*, që realisht është edhe subjekti i hulumtimit.

### 3.3. Sistemi administrativ i *darüşşifa-së*

Çdo shërbim që zhvillohej në këtë spital vetëm se ishte me propozim të personelit adekuat. Puna dhe shërbimi i mjekëve në *darüşşifa* ishte që mbrohej me ligj, kështu që aty shërbenin vetëm persona që kishin vijuar arsimim përkatës.

Ligjet e atëhershme parashikonin që *darüşşifa-ja* duhet të ketë më së paku tre mjekë. Njëri prej tyre ishte me përgjegjësi më të veçantë në rolin e udhëheqjes, mirëpo nuk dalloheshin në trajtimin e pacientëve. Atyre u sigurohej rrogë për shërbimet që kryenin, përderisa pacientët trajtoheshin falas. Në *darüşşifa* kishte mjek me shërbim të specializuar, ndryshe thënë, mjek specialist, që merrej me trajtimin e pacientëve që kishin probleme shëndetësore specifike, dhe njihej me emrin “Kehhal”. Pacientët e tij zakonisht ishin me probleme të oftalmologjisë, me probleme kardiovaskulare apo probleme, cak i të cilave ishte ndonjë organ apo sistem organik. Zakonisht, personeli i këtyre detyrohej të kishte njohuri të detajuara të oftalmologjisë dhe të ketë njohuri për përgatitjen e preparateve oftalmologjike.<sup>19</sup>

Shërbim të veçantë në *darüşşifa* kishte edhe kirurgu, prania e të cilit ishte jetësore. Pacientët e kirurgut zakonisht kishin probleme të plagëve apo nevojë për ndërhyrje kirurgjike. Nga gjithë personeli mjekësor, kirurgët duhej të kishin përvojë të gjerë profesionale dhe gatishmëri për ndërhyrje në raste emergjence.

Barnatorja gjithashtu ishte pjesë përbërëse e *darüşşifa-së*, edhe atë jo vetëm në përmbushjen e nevojave të pacientëve të atij spitali, por gjithashtu, *darüşşifa-ja* e xhamisë Sulejmanije furnizonte me medikamente edhe spitalet e tjera që gjendeshin

<sup>18</sup> Të shihet: Cantay G., *Anadolu Selçuklu ve Osmanlı Darüşşifaları*, Atatürk Kültür Merkezi, Ankara, 1992.

<sup>19</sup> Të shihet: Çoskun Yılmaz, *Osmanlılarda Sağlık*, Biofarma, İstanbul, 2006.

në qytetin e Stambollit. Personeli i barnatores së kësaj *darüşşifa-je* duhej të zotëronte njohuri të jashtëzakonshme për bimët që përdorshin në terapitë mjekësore, të dallonte bimët helmuese, të zotëronte mjeshtëri në përgatitjen barnave, si dhe të përcaktonte se cila përgatitje është për ndonjë diagnozë të caktuar.<sup>20</sup>

*Darüşşifa-ja* posedonte edhe personel që përkujdesej për ushqimin, ku pacientët shërbeheshin në bazë të rekomandimeve të mjekut. Gjithashtu, kishte personel administrativ për mbajtjen e evidencave mjekësore, personel për sigurimin e mjeteve të nevojshme për spitalin, persona që kujdeseshin për sigurinë e spitalit dhe dhe persona me detyra të ndryshme për plotësimin e nevojave të spitalit.

#### 4. Departamenti i psikoterapisë

Dëshira për të kontribuar dhe ndjenja për plotësimin e detyrës personale ndaj shoqërisë bëri që të krijohen risi apo inovacione që do të lehtësonin, plotësonin dhe përmbushnin nevojat shoqërore. Duke u nisur nga kjo pikëpamje, u mundësua që shoqërisë së asaj kohe t'i shtohet spital, rendi dhe metodika e së cilës do krijonin sisteme që edhe sot janë të zbatueshme. Më këtë u dallua *darüşşifa-ja* e xhamisë Sulejmanije, ku për herë të parë u krijua institucion që do merrej me problemet psikiatrike. Edhe pse më herët pretendohet të ketë pasur intervenime në këtë aspekt, ato nuk kanë qenë në nivel dhe shërbim institucional.<sup>21</sup>

Në pjesën e katit të dytë të *darüşşifa-së* së xhamisë Sulejmanije kishte dhoma të specializuara që dalloheshin nga dhomat e pacientëve të thjeshtë, që shërbenin për trajtime psikike. Këtu, pacientët i nënshtroheshin metodave psikoterapeutike, që aplikoheshin nga trajnues të profesionalizuar. Pacientët e këtij departamenti ishin personat me retardim mendor, të çmendurit, ata që kishin stres dhe depresion kronik, ata që humbnin vullnetin për jetesë nga arsye të ndryshme, si humbja e ndonjë të dashuri ose falimentimi, ish-të burgosur e të tjerë.

Këta pacientë kishin personel të veçantë mjekësor dhe u shmangej kontakti me pjesën tjetër të spitalit, mbaheshin në kushte të specializuara dhe evitoheshin nga çdo send që mund të ngjallte iniciativë për zmadhimin e problemit shëndetësor. Ata kishin hapësira të veçanta, ku si pjesë e terapisë obligoheshin të ekspozohen në mjedis të hapur dhe të qetë.

<sup>20</sup> Të shihet: Abdullah Kilic, *Anadolu Selçuklu ve Osmanli Sefkat Abideleri*, vep. e cit.

<sup>21</sup> Gonul Cantay, *Mimar Basi Koca Sinan Yasadigi Cag Ve Eserlei*, Stamboll, 1988, fq. 357.

Nevoja për krijimin e këtij departamenti ishte proporcionale me numrin e pacientëve që ishin për këtë departament. Në disa *darüşşifa* të tjera, numri i pakët i pacientëve të këtitillë e pamundësonte hapjen e një departamenti për psikoterapi, mirëpo kjo varej edhe nga madhësia e shoqërisë, ndërsa realisht, rrethi i xhamisë Sulejmanije e shihte të nevojshme hapjen e tij. Në këtë pjesë pranoheshin pacientët në bazë të rrezikshmërisë së gjendjes. Në përgjithësi, numri më i madh i pacientëve ishte nga të çmendurit, që përkujdesja për ta nga familjarët ishte e pamundur. Pacientët e këtitillë mbaheshin në dhoma të specializuara me kontroll të veçant, ndërsa ata pacientë gjendja e të cilëve ishte e monitorueshme, pas diagnozës mjekësore lëshoheshin në përkujdesje shtëpiake.<sup>22</sup>

Në praktikat mjekësore të osmanëve, mjekët konstatojnë se “çmenduria” është sëmundje që vështirë shërohet ose vetëm monitorohet, mirëpo kishin praktika dhe medikamente që e kontrollonin këtë gjendje. Medikamentet të çmendurive u jepeshin në formën e shurupeve, që ishte më e lehtë që t'i pranonin dhe ishin të përgatitura nga mjekë të profesionalizuar në këtë lëmë. Krahas medikamente, pacientëve të këtij departamenti u jepeshin edhe trajtime të ndryshme, si terapia me muzikë, që ishte një metodë e trashëguar nga studiuesit Ibën Sinait dhe Al Farabiut. Gjithashtu kishte trajtime të trashëguara nga mësimet e lashta mjekësore, si prania në kopshte me lule, dëgjimi i zhurmës së ujit dhe zërat e bukur të zogjve.

#### 4.1. Metodat psikoterapeutike

Metodat psikoterapeutike gjithmonë kanë qenë relevante ndaj referencave që janë përdorur si mostër për zbatimin e praktikave mjekësore. *Darüşşifa-ja* e xhamisë Sulejmanije fillimet e funksionimit dhe zbatimit të praktikave mjekësore i ka bazuar në mësimet dhe informacionet e trashëguara nga perandoritë e mëhershme të Anadollit. Këto metoda të ndikuara nga referenca fetare, që kanë qenë edhe burim i vetëm për atë kohë, gjithmonë janë zbatuar me qëllimin e ndikimit shpirtëror. Mjekët osmanë, në kornizat e problemit mendor, konkretisht çmendurisë, duke e konsideruar atë si problem të shërueshëm, trajtimet e tyre i aplikonin në metoda që subjekt kishin pjesën metafizike të pacientit.

Këto metoda që mjekët i aplikonin ndaj pacientëve kryesisht u referoheshin burimeve natyrore, të cilat ishin në dispozicion koherent, si drita e diellit, shikimi dhe

<sup>22</sup> Abdullah Kiliç, *Anadolu Selçuklu ve Osmanlı Sefkat Abideleri*, vep. e cit., fq. 55.

dëgjimi i ujit, ambienti i hapur me zbulurime, qetësia nga zhurmat e lëvizjeve njerëzore dhe gjithçka tjetër që e ofronte rrethi i *darüşşifa-së*. Shfrytëzimi i këtyre resurseve kishte për qëllim përshtatjen e llojit të sëmundjes dhe metodave të shërimit të asaj sëmundjeje, në këtë rast çmenduria dhe gjithçka që kishte si problematikë psikikën e që ishte metafizike apo shpirtërore, ku medikamentet ishin me diapazon të kufizuar kundrejt ndikimit të kësaj pjese të pacientit.

Përcaktimin e metodave psikoterapeutike mjekësia osmane e përvetësoi nga hulumtimi i detajshëm i problematikës shëndetësore. Hulumtimin e qëlluar të këtyre metodave e saktësoi ndikimi që patën te pacientët, që realisht jo vetëm se arritën të kontrollonin dhe përmirësonin çrregullimet, por edhe të krijonin themel mbi të cilin do të do të zhvilloheshin teknikat e tjera psikoterapeutike të qarqeve bashkëkohore.

#### 4.2. Uji në metodat psikoterapeutike

*Darüşşifa-ja* në metodat psikoterapeutike pjesë të pandashme kishte edhe përdorimin e ujit. Ky përdorim kishte spektër të gjerë të mënyrave, duke filluar që nga obligimi i pacientëve për banjë të nxehtë, freskimi me ujë varësisht nga përshtatja sezonale, deri te shëtitja e pacientit në ambiente me zhurmë të ujit.

Mjekët e profesionalizuar për trajtimin e psikozave konstatojnë se uji në çfarëdo përdorimi të tij ndihmon në lehtësimin e këtyre problemeve, pasi një element nga i cili është i krijuar edhe njeriu duhej që në mënyrë të duhur të nxiste zhvillim funksional të mirëfilltë te trupi i tij.<sup>23</sup>

Kontakti i pacientëve me trajtimet që kishin subjekt ujin fillimisht ishte nëpërmjet hamameve. Aty pacientët kishin kontakt me ujë të nxehtë dhe për një periudhë të caktuar liheshin të pranonin efektet e nevojshme mjekësore, ndërsa kjo praktikë përsëritej për aq herë sa shihej e nevojshme nga mjeku. Po ashtu, kontakti tjetër ishte qëndrimi i pacientit pranë ujit, ku si pjesë e trajtimeve, pacientët duhej që për një periudhë të caktuar kohore të dilnin në ambiente të hapura në të cilat kishte shatërvanë dhe fontana të ndryshme.<sup>24</sup>

Gjatë qëndrimit në këto ambiente, pacientët në mënyrë indirekte ishin të ekspozuar ndaj zhurmës së ujit, në mënyrë që kjo zhurmë apo ky zë të ndikonte në

<sup>23</sup> Të shihet: Ibrahim Zeyd Gerçik, **Her Dem Guçlu**, vep. e cituar.

<sup>24</sup> Të shihet: Ibrahim Zeyd Gerçik, **Her Dem Guçlu**, vep. e cituar

relaksimën psikik të pacientëve. Kjo praktikë për atë kohë ishte pretendim, por a ishte e efektshme apo jo, do ta shtjellojmë te pjesa e rezultateve të hulumtimit.

Gjithashtu, çdo *darüşşifa* si pjesë përbërëse të objektit të saj kishte edhe shatërvan, prania e të cilit nuk ishte vetëm si dekor i objektit, por edhe pjesë përbërëse e metodave psikoterapeutike, sepse dëgjimi i zhurmës së ujit i mundëson njeriut të relaksohet dhe nën ndikimin e këtij relaksimi të lirohet nga stresi dhe energjia negative.<sup>25</sup>

### 4.3. Melodia (Terapia me muzikë)

Në praktikën e terapive psikoterapeutike, vend të veçantë ka përfshirë edhe muzika "e thatë", pa fjalë. Si një referencë e trashëguar nga studiuesit Farabiu dhe Ibën Sinai, kjo praktikë u zbatua në *darüşşifa-të* e hershme të perandorisë së Selçukëve të Anadollit. Edhe në *darüşşifa-të* e kësaj perandorie gjenin zbatim praktikat për evitimin e stresit, si zërat e ujërave, era e mirë, ambienti i hapur, melodi të ndryshme, kopshtet me lule etj. Megjithatë, kjo praktikë edhe më fort u vazhdua në *darüşşifa-të* e xhamive Sulejmanije dhe Bajazit (II).

Sipas pretendimeve të referencave mjekësore të asaj kohe, meloditë e ndryshme ndikojnë drejtpërdrejt në mendjen e njeriut, duke çuar në lëshimin e hormoneve të ndryshme. Me përjetimin e emocioneve, pacientët ndryshojnë nivelin e perceptimit dhe pozicionin psikologjik. Ndryshimet në gjendjen shpirtërore, që shkaktohen nga meloditë e ndryshme, reflektojnë në formimin e zemrave emocionale në trupin e një personi për të formuar një model të ri të karakterit emocional. Sipas llojit të muzikës së dëgjuar, niveli i adrenalines i sekretuar në trup rrit stresin, ndërsa endorfina relakson personin duke ia ulur tensionin, duke rritur energjinë e jetës dhe duke forcuar sistemin imunitar.<sup>26</sup>

Terapia me muzikë për pacientët me probleme psikike filloi të marrë hov në praktikat e perandorisë së selçukëve dhe asaj osmane, sepse fillimisht pati rezistencë ndaj muzikës nga perandoritë e mëhershme si ajo abasite, mirëpo me përhapjen e

<sup>25</sup> Po aty.

<sup>26</sup> Abdullah Kiliç, *Anadolu Selçuklu ve Osmanlı Sefkat Abideleri*, vep. e cit., fq. 57.



tarikatis “sufi” në këto perandori, përdorimi i muzikës përjetoj zbatueshmëri dhe legjitimitet.<sup>27</sup>

Te terapia me muzikë, kishte lloje të ndryshme të zhanreve që u lëshoheshin pacientëve në kohëra të caktuara, për gjendje emocionale të caktuar. Kjo muzikë sigurohej nga orkestra e *darüşşifa-së* e caktuar apostafat për këtë qëllim, në dhoma të caktuara vetëm për këtë trajtim. Gjithashtu, në terapitë e këtilla nuk bënte pjesë vetëm muzika, por edhe meloditë e ndryshme, siç ishin zëri i zogjve, zëri i ujit të shatërvanit, zëri i erërave dhe ezani i xhamisë, që e shpjegon faktin se pozita e *darüşşifa-së* afër xhamisë kishte të bënte edhe me ndërhyrjen e terapeute psikoterapeutike.

#### 4.4. Pozicioni topografik i *darüşşifa-së*

Terapitë në departamentin e psikoterapisë të *darüşşifa-së* së xhamisë Sulejmanije përfshiheshin nga çdo element i mundshëm që mund të ndikonte për të mirë të pacientit, përfshirë këtu edhe reliefin e vendit ku ndodhej objekti. Duke u nisur nga aspekti hormonal për ndërhyrje në gjendjen emocionale të pacientit, pozicioni topografik dhe reliefi i *darüşşifa-së* u mundësonin pacientëve të zhvillojnë përmirësim të gjendjes edhe atë në mënyre eksplicite.

Në të gjitha pjesët e kompleksit të xhamisë Sulejmanije ka kopshte dhe oborre të hapura drejt qiellit, të integruara me tokën, duke lidhur njerëzit me bukuritë universale. Falë kopshtit dhe oborrit, njerëzit në kompleks janë vazhdimisht të vetëdijshëm për ndryshimet klimatike, dritën dhe nxehtësinë e diellit, erën e tokës dhe luleve, ardhjen e pranverës nga lulëzimi i pemëve dhe ciklin e stinëve, në një rrjedhë. Ato rrjedhin në atë rrjedhë, duke shtuar një kuptim të ri në pasurinë e tyre. Njeriu, elementet e institucionit dhe natyra, të gjithë plotësojnë njëri-tjetrin në një. Kontakti me tokën ia mundëson njeriut heqjen e energjisë negative, duke e qetësuar kështu trupin; kontakti me tokën e afron individin me vlerat e qetësisë, durimit dhe përrulësisë.<sup>28</sup>

Arsyeja përse *darüşşifa-ja* në planin urbanistik të saj korrespondon me oborr të hapur, ishte t'u mundësohej pacientëve qasje në qiell të hapur, me pretendimin se shikimi në qiell, ngjyrat e ndryshme të qiellit, ajri i pastër, vështirmi i yjeve, vështrimi

<sup>27</sup> Isil Birkan, “Music therapy, its historical development and applications”, A. Ve T. Tip dergisi, Stamboll, 2014, fq. 40.

<sup>28</sup> Ibrahim Zeyd Gerçik, Her Dem Guçlu, vep. e cituar, fq. 46,47.

i thellë në qiell të hapur, të gjitha këto ndikojnë në qetësimin dhe relaksimin e njeriut nga stresi kronik dhe depresioni.

Arsyeja e përdorimit dhe nënshtimit të pacientëve kundrejt këtyre elementeve natyrore ishte mundësia për të ndikuar në mënyrë indirekte te lirimi i hormonit të kënaqësisë, konkretisht endorfinës.

## **5. Hipoteza apo fakte (rezultatet)**

Formësimi i institucioneve kishte për qëllim përmbushjen dhe ofrimin e zgjidhjeve të problemeve të cilat ishin të pranishme në atë kohë. Pasi *darüşşifa-ja* kryente funksionin e spitalit, qëllimi ishte të përfshihen të gjitha kategoritë shëndetësore të shoqërisë, përfshirë këtu edhe pacientët me probleme psikike, e që ishte subjekt i këtij punimi. Ata arritën të krijonin departamentin, të trajtonin pacientët, të përcaktonin metoda me të cilat do të trajtonin sëmundjet, dhe që në një farë mënyre kishin ndikim, mirëpo parashtrohet pyetja se sa këto metoda në të vërtetë ishin të efektshme duke u bazuar në aspektet mjekësore, përgjigjen e së cilës do ta shtjellojmë në vazhdim.

Në grupin e metodave psikoterapeutike, pjesë përbërëse ishin edhe medikamentet, mirëpo për arsye të mospasjes së recetave autentike, në shtjellimin tonë shkencor do të fokusohemi tek ato praktika që bazoheshin në elementet natyrore.

### **5.1. Uji ndikon në relaksimin e njeriut?!**

Te metodat psikoterapeutike, kemi cekur që uji ka pasur pozitë vitale në trajtimet shëndetësore. Përdorimi i ujit ka qenë relativ nga lloji i trajtimit, duke u përfshirë mënyra direkte dhe indirekte. Prej mënyrave indirekte ka qenë prania e shatërvanit në hapësirat e *darüşşifa-së*, ku është pretenduar se dëgjimi i zhurmës së ujit ndikon në relaksimin dhe lehtësimin e psikozave.

#### **Aspektet mjekësore**

Duke u bazuar në teoritë dhe faktet shëndetësore që do t'i cekim në vijim, është vërtetuar se cilido “lloj” i përdorimit të ujit, qoftë edhe ndeja afër ujit, është që ndikon në relaksim psikik, por edhe atë fiziologjik të njeriut. Uji i mundëson njeriut të lirohet nga energjia negative, të lirohet nga stresi dhe depresioni akut, të ketë lehtësim të psikozave kronike dhe stabilitet të nevojshëm hormonal. Për të bërë hulumtimin

aktual me rezultate bashkëkohore, dëshmia që do e mbrojë hipotezën e mësipërme është një hulumtim i zhvilluar kohëve të fundit.

Ky hulumtim i zhvilluar nga Universiteti i Exeter-it i Mbretërisë së Bashkuar, që përfshinte një numër të madh të pjesëmarrësve, dëshmoi për ndikimin pozitiv të ujit dhe përdorimit të tij. Dëshmia e ndikimit të këtyre të ujit në trajtimin e psikozave, në literaturat e atëhershme bazohet në përshtypjet e njerëzve kundrejt kësaj metode, mirëpo duke e krahasuar këtë gjendje me hulumtimet bashkëkohore, vërejmë se teknikat që janë përdorur në atë kohë nuk kanë qenë të rrafshit hipotetik, edhe përkundër mungesës së fakteve shëndetësore.

Hulumtimet më të fundit që zhvillohen në këtë sferë dëshmojnë kategorikisht saktësinë e përdorimit të ujit për qëllime terapeutike. Studimi më i fundit i publikuar në gazetën britanike "The Guardian" më datë 03.11.2019 dëshmon për këtë saktësi. Studimi që hulumtonte ndikimin e hapësirave ujore në përmirësimin e mirëqenies së njeriut dhe shtimin e lumturisë, përfshinte celularët e 20.000 personave, për të regjistruar ndjenjën e tyre të mirëqenies në mjedisin e tyre të rastësishëm në interval të rastësishëm.

Studimi rezultoi me konstatimin se personat që kalonin kohën afër hapësirave ujore kishin potencial të lumturisë dhe mënjanim të stresit gjashtë herë më shumë sesa personat në hapësirat normale urbanistike. Me hapësirat ujore, në këtë studim përfshihen edhe shatërvanët, prania e të cilëve iu mundëson njerëzve të relaksohen dhe të kenë ndjenjën e qetësisë. Ajo që lidh metodat psikoterapeutike të *darüşşifa-së* me studimin e caktuar është se, përveç përdorimit të ujit të nxehtë për pacientët, në *darüşşifa* gjithashtu kishte edhe shatërvan, që realisht përdorej për qëllime terapeutike.

Studimi po ashtu konstaton se me hapësirat ujore, mund të përmbledhim edhe vendet që korrespondojnë me pamje bregdetare, që faktikisht edhe shikimi drejt hapësirave ujore, në këtë rast deti, ia mundëson psikikës së njeriut relaksim. Relacioni topografik i përshtatet edhe kësaj pike, sepse dritaret e objektit dhe veçanërisht dhomat e departamentit të psikoterapisë ofronin këtë lloj të pamjes, që në një mënyrë të ndikojë në përmirësimin e gjendjes së pacientit.<sup>29</sup>

---

<sup>29</sup> <https://www.theguardian.com/lifeandstyle/2019/nov/03/blue-space-living-near-water-good-secret-of-happiness> (Shfletuar më 12.09.2019)

Gjithashtu, nga të gjitha llojet e përdorimit të ujit për qëllime terapeutike, është konstatuar se kjo ndihmon në rritjen e niveleve të vitaminës D, ndikimin e së cilës do ta shtjellojmë tek elementet topografike.

Provat epidemiologjike tregojnë se ekspozimi më i madh ndaj ose kontakti me mjedise natyrore (siç janë parqet, pyjet dhe plazhet) shoqërohet me shëndet dhe mirëqenie më të mirë, të paktën në mesin e popullatave me hyrje të larta, kryesisht në shoqëri të urbanizuara.<sup>30</sup>

## 5.2. Pozicioni topografik, ndikimet direkte dhe indirekte

Themeli i metodave psikoterapeutike të departamentit të psikoterapisë në *darüşşifa-në* e xhamisë Sulejmanije ishte ekspozimi ndaj elementeve natyrore. Duke u nisur nga ky koncept, dhe hipotezat për ndikueshmëri, pothuajse të gjitha trajtimet ndaj pacientëve ishin të varura nga aspektet natyrore. Personeli mjekësor për pacientët me retardim mendor organizoi një plan të veçantë për këto trajtime, si dalja në qiell të hapur, kontakti me tokën, prekja e luleve, dëgjimi i zërit të ujit që vinte nga shatërvanët, dëgjimi i zërave të zogjve, nuhatja e aromave, që të gjitha këto ishin në plan ditor të një pacienti në këtë departament. Siç e shihni, trajtimi më primar në *darüşşifa* ishte ndikimi natyror, pasi që gjitha proceduarat e lartpërmendura kanë një pikë të përbashkët, që është natyra.

Këto trajtime dhe planifikimi i tyre në planprogramin ditor ishte nga rekomandimet mjekësore dhe nga perspektiva mjekësore e personelit. Këto aktivitete ishin me ndikim të drejtpërdrejt. Mirëpo, ato që e zgjerojnë këtë trajtim janë edhe ndikimet jo të drejtpërdrejta, si reliefi, gjerësia gjeografike, topografia, afërsia bregdetare, helioterapia<sup>31</sup> etj.

### Aspektet mjekësore

Ndikimin më të rëndësishëm të kësaj natyre të trajtimeve e ka pasur drita e diellit. Pozicioni topografik, përshtatshmëria e relievit dhe gjerësia gjeografike i kanë mundësuar *darüşşifa-së* reflektimin e një helioterapie të theksuar.

Pozicioni i *darüşşifa-së*, në aspektin gjeografik ka qenë në masë të madhe i ekspozuar ndaj dritës së diellit, qoftë edhe në aspektin ditor, por edhe atë sezonal.

<sup>30</sup> Hartig, T. & Kahn, P. H. **Living in cities, naturally**. Science, Londër, 2016, fq.256.

<sup>31</sup> Mjekimi i disa sëmundjeve me anë të rrezeve të diellit.

Qëllimi i nxjerrjes së pacientëve në ambient të këthillë kishte për qëllim ekspozimin ndaj dritës së diellit.

Drita e diellit ndikon në mirëqenien psikike të njeriut<sup>32</sup>, edhe atë në dy mënyra. Mënyra e parë vjen nga ndikimi i rrezeve të diellit në lëkurë, ku si pasojë e këtij rrezatimi ultraviolet, qelizat që gjenden në shtresën e jashtme të lëkurës, të quajtura “keratocite”, të cilat stimulojnë sekretimin e hormonit endogjen  $\beta$ -endorfin, hormon ky që është




FIGURA 1 NJË PARAQITJE SKEMATIKE E NGJARJEVE FOTOKIMIKE DHE TERMIKE QË REZULTOJNË NË SINTEZËN E VITAMINËS D3 NË LËKURË.

përgjegjës për shumë elemente të gjendjes emocionale, duke u ndërlidhur edhe me atë të sjelljes.

Ekspozimi ndaj diellit nuk u mjaftua vetëm me sekretimin e hormoneve endrofine, por gjithashtu drita e diellit dhe rrezet ultravioletë ndikojnë në sekretimin e hormonit të serotoninës,<sup>33</sup> hormon ky përgjegjës për ndjesinë e të qenit i rëndësishëm dhe gëzimin e autoritetit të njerëzit. Në mungesë të këtij hormoni, njeriu ndjen depresion dhe vetmi. Sekretimi i serotoninës gjithashtu stimulohet nga qelizat e epidermës, nga ndikimi i dritës së diellit.

Mënyra e dytë, që realisht ka pasur ndikim indirekt në trajtimin e pacientëve të *darüçşifa-së*, duke i mundësuar elemente natyrore më ndikuese, ka qenë edhe

<sup>32</sup> Matthias Wacker & Michael F. Holick <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC3897598/> (Shfletuar më 12.08.2019)

<sup>33</sup> Randy A. Sansone & Lori A. Sansone <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC3779905/#B23> (Shfletuar më 12.08.2019)

pozicioni gjeografik i qytetit të Stambollit. Pozita që ka gëzuar *darüşşifa-ja* në aspektin topografik, duke përfshirë edhe reliefin e vendit, ka mundësuar që drita e diellit, temperaturat vendore dhe afërsia bregdetare të rezultojnë me ndikime indirekte, që ndoshta edhe nuk kanë qenë të hezitueshme nga personeli mjekësor.

Prej faktorëve që kanë ndikuar në rrezatim më të mirë të dritës së diellit dhe temperaturave të balancuara ka qenë edhe gjerësia gjeografike (latitude). Afërsia ndaj vijës së Ekuatorit mundëson elemente natyrore me ndikim më të theksuar, si ndriçim më të gjatë të rrezeve të diellit, lagështi ajrore, mbrojtje nga rrezet me ndikim radioaktiv, të reshura të rregullta të shiut dhe gjelbërim.




FIGURA 2 NDIKIMI I STINËS, ORA E DITËS DHE GJERËSIA E GJATËSISË NË SINTEZËN E PROVITAMINËS D<sub>3</sub> NË HEMISFERAT VERIORE (A DHE C) DHE JUGORE (B DHE D).

Duke u bazuar në matjet e ndikimit të gjerësisë gjeografike nga qytete të ndryshme, vërejmë se qytetet që gjenden më afër vijës ekuatoriale kanë potencial më të theksuar dhe ndikim më afatgjatë për përsheptim të funksioneve fiziologjike, në këtë rast stimulim të hormoneve përkatëse për relaksim mendor.

Qyteti i Stambollit gjithashtu shpreh një afërsi dhe mundësi të lartë të gjerësisë ekuatoriale, kështu, edhe vendndodhja e *darüşşifa-së* në këtë qytet, ka mundësuar që terapitë dhe trajtimet psikioterapeutike të kenë ndikim dhe rezultate më efektive. Po

ashtu, edhe afërsia ndaj vijës bregdetare ka ndikuar ne elemente natyrore më të theksuara, me këtë edhe trajtime më produktive.

## Literatura

Altınbaş, Ayten: **Osmanlılarda Tıp Egetimi**, Osmanlı Devleti'nin Sağlık Hizmetleri Sempozyumu, Ankara, 2000.

Bayat, Ali Haydar: **Tıp Tarihi**, Zeytinburnu Bel.Kültür Yay. İstanbul, 2016.

Birkan, Isil: "Music therapy, its historical development and applications", **A. Ve T. Tıp dergisi**, Ankara, 2014.

Çantay, Gonul: **Mimar Basi Koca Sinan Yasadigi Cag Ve Eserlei**, Kervansaraylar Ayri Basim, İstanbul, 1988.

Çantay, Gonul: **Anadolu Selçuklu ve Osmanlı Darüşşifaları**, Atatürk Kultur Merkezi, Ankara, 1992.

Gerçik, İbrahim Zeyd: **Her Dem Güçlü**, Yonetim, İstanbul, 2009.

Gerçik, İbrahim Zeyd: **Her Dem Yeni**, Yonetim, İstanbul, 2009.

Hartig, T. & Kahn, P. H.: **Living in cities, naturally**, The Journal of Science, USA, 2016.

Kilic, Abdullah: **Anadolu Selçuklu ve Osmanlı Sefkat Abideleri**, Mediapark, İstanbul, 2012.

Hartig, T. & Kahn, P. H.: **Living in cities, naturally**, The Journal of Science, USA, 2016.

Mulayim, Selcuk: **Ters Lale Osmanlı Mimarisinde Sinan Cagi ve Suleymaniye**, Arkeoloji ve Sanat Yayinlari, Kanaat Basim Evi, İstanbul, 2001.

Mustafa Celal, Seyyid Lokman: **Hunername**, Yapı Kredi - Doğan Kardeş, İstanbul, 1969.

Necipoğlu, Gülrü: **The Age of Sinan: Architectural Culture in the Ottoman Empire**. London: Reaktion Books, 2005.

Yılmaz, Coskun: **Osmanlılarda Sağlık**, Biofarma, İstanbul, 2006.

White Mathew, University of Exeter: (Shfletuar më 19. 08.2019)  
<https://www.theguardian.com/lifeandstyle/2019/nov/03/blue-space-living-near-water-good-secret-of-happiness>)

Matthias Wacker & Michael F. Holick  
<https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC3897598/> (Shfletuar më 12.08.2019)

Randy A. Sansone & Lori A. Sansone  
<https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC3779905/#B23> (Shfletuar më 12.08.2019)

## SHQYRTIME RRETH FERMANIT TË REFORMAVE NË SHTETIN OSMAN

Semran Murtezani<sup>1</sup>

**Abstrakt:** *Fermani i Reformave është një dokument i rëndësishëm, që ka arritur të prekë dhe të jetë pikënisje për ndryshime të caktuara në shoqërinë e shtetit osman. Periudha kur është shpallur, rrethanat që kanë ndikuar në shpalljen e tij, si dhe forma dhe përmbajtja e tij, janë objekt i studimi dhe shqyrtimit të këtij punimi.*

**Fjalët kyçe:** Fermani i Reformave, Tanzimati, Modernizimi, Shteti Osman

### 1. Hyrje

Fermani i Reformave është shpallur në vitin 1856, në periudhën e Tanzimatit, e cila karakterizon periudhën kur shteti osman ishte futur në një proces shumë delikat, në atë të reformimit të strukturës ushtarake, juridike, ekonomike, sociale dhe të tjera. Viti deri kur është shpallur Fermani i Reformave, shteti osman veçse kishte miratuar dhe kishte zbatuar akte dhe reforma të caktuara, por paraqitet dilema se pse dhe cilat ishin arsytet që të shpallet edhe Fermani i Reformave.

Ky ferman është shpallur për shkak se konsiderohej se reformat e realizuara më herët nuk kishin arritur që t'i plotësonin tërësisht kriteret që kërkoheshin për modernizimin e shtetit osman. Prandaj, rëndësia e Fermanit të Reformave është se parashihte një horizont më të gjerë dhe më thelbësor të të drejtave, parimeve dhe reformave në shumë sfera, si ushtri, tregti, ekonomi, administratë, liri fetare e të tjera.

Pika e parë e këtij punimi përmban sqarime rreth epokës së Tanzimatit, për shkak se Fermani i Reformave është shpallur pikërisht në këtë periudhë, cilat kanë qenë karakteristikat e tij, udhëheqësit dhe përfundimi i tij.

Pika e dytë përmban sqarime rreth formës dhe statusit juridik të fermanit. Objekt diskutimi është se cilat janë pjesët përbërëse të tij dhe dilema se a ka arritur

<sup>1</sup> Studime Master në drejtimin e Drejta Ndërkombëtare, Universiteti i Evropës Juglindore



Fermani i Reformave të përbëjë një akt kushtetues apo jo, që si çështje do të sqarohen në këtë pjesë.

Pika e tretë e punimit përmban sqarime të përmbajtjes së Fermanit të Reformave. Në këtë pjesë është bërë sqarimi dhe analizimi i dispozitave juridike që përmban fermani.

Pika e katërt elaboron faktorët që ndikuan në formulimin dhe miratimin e Fermanit të Reformave.

Pika e pestë përmban gjetjet e këtij punimi.

## 2. Epoka e Tanzimatit

Çdo shoqëri, brenda rrjedhës së kohës, vazhdimisht kalon nëpër ndryshime. Pa dyshim, edhe shoqëria osmane nuk mund të qëndronte jashtë këtij rregulli të përgjithshëm.<sup>2</sup> Disa shtete të asaj kohe veçmë kishin filluar procesin e modernizimit, si Rusia<sup>3</sup> dhe Japonia<sup>4</sup>, dhe sistemi ndërkombëtar kishte filluar të funksiononte sipas parimeve moderne, gjë që konstaton faktin se procesi i modernizimit ishte i domosdoshëm edhe për shtetin osman.

Historiani Ilber Ortaylı për këtë situatë jep një sqarim të këtillë: "Ne nuk mund ta konceptojmë dot faktin dhe ndryshimin e oksidentalizimit në Perandorinë Osmane, vetëm duke pasur parasysh Portën e Lartë dhe pjesën e Anadollit. Për shkak të nevojave ushtarake të Perandorisë Osmane, ajo kishte nevojë që t'i afrohej më përpara botës, mendimit dhe letërsisë evropiane. Admiruesit e oksidentalizimit të shoqërisë osmane e preferuan Perëndimin, jo për shkak të këtij admirimi, por për shkak të nevojës."<sup>5</sup>

Kjo domosdoshmëri nuk është se u paraqit vetëm në periudhën e Tanzimatit kur shpallen dy fermanet më të rëndësishme, por themelet e saj ishin hedhur qysh 100 vjet më herët. Kjo karakterizohet me marrëveshjen e Karlovcit, me tentativat e Ibrahim Myteferrikasë për hapjen e një shtypshkronje, të cilën më pas e realizon

<sup>2</sup> Ilber Ortaylı, **Shekulli më i gjatë i Perandorisë**, Logos-A, Shkup, 2010, f. 8.

<sup>3</sup> Disa aristokratë rusë i mobilonin shtëpitë e tyre sipas mënyrës evropiane. Ata bënë një jetë sipas stilit barok dhe të Rilindjes, si dhe jetën e tyre ia përshtasin traditave gjermane.

<sup>4</sup> Me konceptin shpirti japonez, teknika evropiane

<sup>5</sup> Ilber Ortaylı, **Shekulli më i gjatë i Perandorisë**, Logos-A, Shkup, 2010, f. 25.

Ibrahim pashai, *Nizam-ı Cedid-in*, që parashihte reformimin, faktikisht modernizimin e ushtrisë osmane, dhe disa veprime të tjera.

Një proces reformimi pa dyshim që duhej të ndodhte, sepse e bënin të pashmangshëm situatat brenda dhe jashtë shtetit osman. Por, komoditeti, strategjia dhe uniteti i brendshëm nuk ishin të definuara qartë për të udhëhequr procesin e modernizimit. Nga ana tjetër, situatën e vështirësonin dhe e pengonin edhe më shumë popullata dhe elita konzervative e shtetit osman, të cilët pretendonin se reformat ishin në kundërshtim me të drejtën islame.

Kuadrot në sferën e arsimit, ekonomisë, tregtisë, administratës, shëndetësisë dhe drejtësisë nuk ishin në gjendje që të përballojnë një barrë të tillë, sepse nuk kishin përgatitje profesionale sipas standardeve moderne.

Procesi i modernizimit në shtetin osman është fakt se ka qenë i domosdoshëm, por edhe shumë i dhimbshëm. Ky proces arriti të implementohet deri në vitin 1878 dhe përfshin një periudhë 39-vjeçare.

Në përgjithësi, reformat nuk arritën të implementohen në mënyrë të duhur dhe dështuan, por konceptet, parimet dhe standardet që u vendosën në këtë periudhë janë zanafilla e ndryshimeve të situatave dhe ngjarjeve të mëvonshme në shtetin osman.

Enti i Gjuhës Turke termin Tanzimat në kuptimin etimologjik e përcakton se rrjedh nga arabishtja e vjetër: tanzīm - njëjës, tanzīmāt - shumës; të riorganizosh, të riaftësosh, të reformosh.<sup>6</sup>

Tanzimati është nismë reformatore, e cila filloi në vitin 1839, me shpalljen e Fermanit të Tanzimatit nga Sulltan Abdulmexhiti,<sup>7</sup> që nënkuptonte hedhjen e themelit të procesit të modernizimit të shtetit osman.<sup>8</sup>

Fermani i Tanzimatit, konkretisht periudha e Tanzimatit, në historiografi, paraqitet si pikënisja e parë e modernizimit të shtetit osman. Fermani i Tanzimatit përmban reforma si: “garantohej paprekshmëria e jetës, e nderit dhe e pasurisë për të

<sup>6</sup> Türk Dil Kurumu Sözlüğü: <https://sozluk.gov.tr/?kelime=TANZ%C4%B0MAT> shikuar më 15.11.2019.

<sup>7</sup> Ai lindi më 25 prill 1823. Në kohën kur udhëhiqte me shtetin dhe shpalli Fermanin e Tanzimatit ishte vetëm 16 vjeç. Ai arriti të udhëheq me shtetin osman rreth 22 vite. Ndërron jetë më 25 qershor 1861, në moshën 38 vjeçare, nga sëmundja e tuberkulozit.

<sup>8</sup> Në këtë punim do t'i referohemi termit shteti osman, sepse në dokumentetzyrtare të saj është përdorur Devlet-i Âliye (Shteti i Lartë Osman), dhe nuk është përdorur termi perandoria.

gjithë shtetasit osmanë, pa dallim feje; hiqej konfiskimi i pasurisë për ata që paditeshin në gjykatë dhe fëmijët e tyre nuk privoheshin nga e drejta e trashëgimisë së pasurisë; vendosej ndarja dhe mbledhja e rregullt e taksave dhe hiqej sistemi i sipërmarrjes së tyre (iltizami); futej shërbimi i rregullt ushtarak dhe shkurtohej afati i tij; shërbimi i rregullt (nizami) do të zgjaste 4-5 vjet, ndërsa ai rezervist (redifi) shtatë vjet.”<sup>9</sup>

Situatat pas shpalljes së tij vërtetojnë se ky dekret nuk e dha efektin e duhur për të implementuar ndryshimet e parapara dhe si pasojë e kësaj, në vitin 1856 shpallet Fermani i Reformave, me një përmbajtje më të zgjeruar dhe më thelbësore, për të përmbushur zbrazëtitrat dhe qëllimet të cilat nuk ia doli t'i përmbushë Fermani i Tanzimatit.

### 3. Forma dhe natyra juridike e Fermanit të Reformave

Sistemi juridik në shtetin osman përbëhej nga e drejta islame dhe e drejta e sulltanit apo ligjet që i sillte, të cilat ishin të patjetërsueshme të jenë në përputhje me të drejtën islame. Në kuadër të kësaj të drejte, sulltani shpallte fermane (dekrete) për çështje dhe sfera të ndryshme në shtetin osman. Një ndër ta është edhe Fermani i Reformave. Ky ferman u shpall më 18 shkurt 1856 nga Sulltan Abdulmexhiti.

Sipas aspektit etimologjik, fjala "ferman" rrjedh nga persishtja, që do të thotë urdhër, dekret i shkruar i sulltanit, i cili në fund mban shenjën, firmën (tugën) e tij.

Fermani në aspektin strukturor ka invokacionin, pastaj tugën, tekstin, emrin dhe funksionin e pranuesit të fermanit.<sup>10</sup> Ndërkaq, në gjuhën turke, fermani quhet "*Islahat Fermani*", dhe fjala *Islahat* rrjedh nga njëjësi i fjalës *Islah* - reformë, *Islahat* - reforma, pra shumësi i fjalës reformë.

<sup>9</sup> Nexhat Ibrahim, **Leksikoni Islam**, Logos-A, Shkup, 2012, f. 302

<sup>10</sup> Nexhat Ibrahim, **Leksikoni Islam**, Logos - A, Shkup, 2012, f. 119.



Fotografia 1. Fermani i Reformave – që gjendet në Arkivin e Stambollit



Fotografia 2. Tuga (shenja) e Sulltan Abdülmexhitit

Në fotografinë numër 2<sup>11</sup> është e paraqitur shenja (tuga) e Sulltan Abdülmexhitit, e cila ka shërbyer si nënshkrim, shenjë për identifikimin e tij. Aty është i shkruar emri i babait të sulltanit (Mahmudi II), emri i sulltanit (Abdülmexhit) dhe lutja *el-muzaffer dâimâ*, që do të thotë gjithnjë fitimtarë. Shenja të këtilla kanë pasur të gjithë sulltanët që kanë udhëhequr shtetin osman.

Ndërkaq, sipër në të djathtë shënon “*mucebince amel oluna*”, që do të thotë “*le të zbatohet urdhri*”

“Fermani i Reformave për nga forma dhe përmbajtja, ajo që në mënyrë të prerë mund ta themi është se Fermani i Reformave, nuk është as kushtetutë dhe as ligj. Por, është lloji i dokumentit *chârta* (kartë).”<sup>12</sup> “Karta është deklaratë formale që parasheh të drejtat e qytetarëve të vendit, ndonjë organizate, apo grupi social të caktuar, dhe që është e miratuar nga ana e sundimtarit ose qeverisë.”<sup>13</sup> Përmbajtja e saj është shumë e kufizuar për të pasur statusin e një kushtetute.

Kushtetuta në korniza më të zgjeruara përmban kompetencat e qeverisë ose kryetarit të shtetit, të drejtat dhe liritë e njeriut, kompetencat dhe detyrat e institucioneve të shtetit, kompetencat e parlamentit dhe kompetencat e organeve

<sup>11</sup> Të shihet: Arkivi Shtetërorë i Kryeministrisë së Republikës së Turqisë "Osmanlı Fermanları" Numri i botimit: 63, Ankara, 2003, f.351. [devletarsivleri.gov.tr/osmanli\\_fermanlari](http://devletarsivleri.gov.tr/osmanli_fermanlari)

<sup>12</sup> Niyazi Berkes, *Türkiye'de Çağdaşlaşma*, Yapı Kredi Yayınları 16. Baskı, İstanbul, 2011, f. 214.

<sup>13</sup> Fjalori Online i Kembrixhit: <https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/charter> shikuar më 10.12.2019.

gjyqësore. Siç do të vihet re edhe në pjesën e analizës së përmbajtjes së fermanit pak më poshtë, vërtetohet se ai nuk i përmban të gjitha elementet që e përbëjnë një kushtetutë. Ai është i kufizuar me përmbajtjen e të drejtave politike, fetare, sociale dhe ekonomike, si dhe ka mungesën e përmbajtjes së rregullave për themelimin, funksionimin dhe kompetenca të tjera për institucionet primare të shtetit.

Sidoqoftë, ky ferman ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në procesin për sjelljen e një kushtetute në shtetin osman, duke përgatitur themelet dhe parimet për periudhën e mëvonshme për inkorporimin e një kushtetute në shtetin osman. Fermani është pjesë e një zinxhiri dokumentesh që i kanë paraparirë kushtetutës.

#### 4. Shqyrtime rreth përmbajtjes së Fermanit të Reformave<sup>14</sup>

Fermani i Reformave përbëhet prej 35 dispozitave. Në origjinalin e Fermanit të Reformave teksti nuk është i ndarë në nene, por *Bianchi* këtë ferman e ka strukturuar në 35 dispozita bashkë me preambulën.<sup>15</sup>

Në këtë punim janë sqaruar dhe komentuar disa prej dispozitave që kanë arritur të sjellin ndryshime më të theksuara në shtetin osman.

1. Dispozitat e parapara në Fermanin e Tanzimatit, të cilin e kemi përmendur në pjesën e epokës së Tanzimatit dhe normat e tij, në këtë ferman ripërsëriten dhe përforcohen edhe më shumë. Jeta, pasuria dhe nderi janë të paprekshme për të gjithë qytetarët e shtetit osman, pa dallim feje ose secti. Miratohet parimi i barazisë për të gjithë qytetarët, si myslimanët, ashtu edhe jomyslimanët.

2. “Personat jomyslimanë që u takojnë grupeve të ndryshme të komuniteteve, u zyrtarizohet liria e komuniteteve, që me komisionet që do të formohen me lejen e sulltanit, do të kenë të drejtë të diskutojnë për të drejtat që do u jepen atyre dhe të bëjnë propozime. Në të njëjtën kohë, ky nen inkorporon në akt juridik parimin e përfaqësimit”<sup>16</sup>. Në fakt, jomyslimanët, edhe para shpalljes së këtij fermani kanë gëzuar një numër të madh të drejtash. “Një numër i madh i privilegjeve që jomyslimanët kanë gëzuar më herët, kanë vazhduar t’i gëzojnë edhe në periudhën e

<sup>14</sup> Përmbajtja e Fermanit të Reformave: Muharrem Balcı, *Tanzimat’tan Günümüze*, 20 Mayıs, 2000, f. 47. <http://www.muhammedbalci.com/yayinlar/tebligler/52.pdf>

<sup>15</sup> T. X. Bianchi, *Charte Imperiale Ottomane*, Original from **University of Wisconsin** (Digitized by GOOGLE), Paris, 1856.

<sup>16</sup> Musa Gümüş, *Anayasal Meşrûfî Yönetime Medhal: 1856 Islahat Fermanı’nın Tam Metin İncelemesi*, 2008, f. 220.

Tanzimatit. Nëse e përdorim terminologjinë moderne të të drejtave të njeriut, mund të themi se 'miletet' jomyslimane kanë gëzuar plotësisht të drejtat e veçanta të minoriteteve.”<sup>17</sup>

3. Pengohet dhënia e dhuratave dhe të ardhurave të tjera priftërinjve me çdo kusht, dhe në vend të tyre, patriarkëve dhe liderëve të komuniteteve u sigurohen të ardhura të caktuara.

4. Me mjete të buxhetit të shtetit, do të bëhet restaurimi, por sipas nevojës edhe ndërtimi, i të gjitha shkollave, spitaleve, varrezave dhe objekteve të tjera, që ndodhen në qytete dhe qyteza, të të gjitha feve dhe sekteve.

5. Për objektet të cilat do të duhet të rindërtohen, liderët e komuniteteve do të duhet të paraqesin kërkesë deri te sulltanati, dhe në rast se nuk paraqet ndonjë pengesë, ajo do të miratohet.

6. Tërhiqen deri në pafundësi të gjitha shprehjet dhe konceptet zyrtare që favorizojnë një klasë dhe nënçmojnë një klasë tjetër.

7. Një ndër dispozitat që ka bërë ndryshime thelbësore, është liria e ndërrimit të fesë. Në këtë dispozitë, theksohet se askush nuk mund të pengohet në ndërrimin nga një sekt në sekt tjetër, dhe nga një fe në fe tjetër.

8. Me pëlqimin e sulltanit, lejohet zgjedhja dhe emërimi i çdo qytetari osman, pavarësisht cilit komunitet i takon, në poste të larta të udhëheqjes dhe administratës së shtetit osman.

9. Jomyslimanët të cilët nuk marrin pjesë në ushtri, do të paguajnë çmim (bedel) për mospjesëmarrjen e tyre.

10. Ndikimin më të theksuar, Fermani i Reformave e ka pasur në çështjen e arsimit. Lejohet hapja e shkollave nga çdo komunitet (milet), si nga myslihanët dhe jomyslihanët, por metodat e mësimit dhe emërimi i mësimdhënësve, do të përcaktohen nga këshilli i përzier (kjo nënkupton pjesëmarrjen e personave në këshill të përkatësisë myslimane dhe jomyslimane, faktikisht, risia është pjesëmarrja e jomyslihanëve), i emëruar paraprakisht nga sulltani.

---

<sup>17</sup> Berdal Aral, *The Idea of Human Rights as Perceived in the Ottoman Empire*, **The Johns Hopkins University Press**, 2004, f. 478.

11. “Paditë nga lëmi i së drejtës penale dhe tregtare, që do të lindin ndërmjet myslimanëve dhe jomyslimanëve, por edhe ndërmjet jomyslimanëve, do të procedohen nga gjykata të përziera, dhe në këto gjykata, gjykimi do të jetë i hapur, do të pranohet dëshmia e jomyslimanëve, dhe çdokush do të betohet sipas rregullave fetare të tyre.”<sup>18</sup> Nga ky rregull, jomyslimanëve u njihet e drejta për të dëshmuar në procedura gjyqësore, si dhe paditë do të shqyrtohen me përbërje të përzier të gjyqtarëve. Para kësaj, personi kompetent për shqyrtimin e padive ka qenë kadiu, i cili ka shqyrtuar paditë që parashtroheshin nga myslimanët. Jomyslimanët paditë e tyre i kanë paraqitur në gjykata të jomyslimanëve dhe çështja e tyre është shqyrtuar në bazë të rregullave fetare të tyre. Ata gjithashtu kanë pasur të drejtë të parashtrojnë padi te kadiu, ku çështja është shqyrtuar në bazë të rregullave të së drejtës islame, dhe numri i jomyslimanëve që kanë parashtruar padi te kadiu, në vend të gjykatave të tyre, është i madh.

12. Përcaktohet sistem i ri i kushteve dhe rregullave, faktikisht modernizimi i burgjeve. Këto rregulla do të jenë të përcaktuara nga ana e sulltanatit, dhe në bazë të tyre ndalohet dënimi trupor, keqtrajtimi dhe tortura, dhe veprime të ngjashme, ndërsa administratorët që do t'i ushtrojnë të ato, do të dënohen sipas ligjit penal.

13. Një pjesë e konsiderueshme e fermanit i dedikohet ndryshimeve që parashiheshin të bëhen sa i përket pagesës së tatimeve. Në të gjitha këto parashihet barazia në tatime dhe detyra, pra, tatime shtetit do t'i paguajnë njësoj, si myslimanët, ashtu edhe jomyslimanët, pavarësisht se cilit sekt apo klasë i takojnë. Tatimet janë paraparë që të mblihdeshin drejtpërdrejt nga qytetarët, pa asnjë ndërmjetësues, për të parandaluar keqpërdorimet e mundshme gjatë mbledhjes së tyre.

14. Rregullat ligjore në lidhje me vjedhjet, prishjet e rendit publik dhe keqpërdorimit të detyrës, do të vlejnjë njësoj për tërë popullatën, pavarësisht cilës klasë i takojnë.

15. Parashihej marrja e iniciativave për rregullimin punëve të politikave monetare dhe politikave financiare të tjera, hapja e rrugëve dhe metodave për zbatimin e pasurive materiale dhe kapitalit në shtetin osman. Rëndësia e kësaj është se për herë të parë lejohet hapja e bankës në shtetin osman, e cila është quajtur "Banka

<sup>18</sup> Gazi Erdem, *Islahât Fermânî'na Yeniden Bir Bakış*, Ankara, *Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, f. 337-338.

Osmane". Kjo u arrit me ndihmën e mbretëreshës britanike Viktoria, e cila dhuroi 500.000 sterlina kapital për themelimin e Bankës Osmane.<sup>19</sup>

16. Për këtë shkak, do të përfitohet dhe zbatohet nga shkenca, edukimi dhe kapitali evropian.

17. Neni i fundit i fermanit sqaron dhe i drejtohet kryeministrit (sadraxem) se fermani duhet të shpallet dhe të informohen të gjithë, në Stamboll dhe në çdo anë të shtetit, për zbatimin e tij, si dhe gjetjen dhe zhvillimin e rrugëve dhe metodave për implementimin e tij.<sup>20</sup>

## 5. Faktorët që ndikuan në shpalljen e Fermanit të Reformave

Acarimi i marrëdhënieve ndërmjet shtetit osman dhe Ruisë lindi si pasojë e mosmarrëveshjeve për vendet e shenjta në Jerusalem, ku Rusia kërkonte të shpallte një ferman për mbrojtjen e të drejtave të ortodoksëve në këtë qytet. Shteti osman refuzoi një kërkesë të këtillë.

Si pasojë e këtij zhvillimi, më 4 tetor 1853, fillon Lufta e Krimesë. Pas një periudhe gjatë luftës, forcat ushtarake të shtetit osman fillojnë të humbasin epërsinë që kishin në luftë dhe në ndihmë u vijnë forcat ushtarake të Anglisë dhe Francës, pra shteti osman krijon aleancë me këto dy shtete, ndërsa më vonë iu bashkangjiten Austria dhe Prusia.

Rusia paraqiste një rrezik dhe armik të jashtëzakonshëm për shtetin osman, prandaj, shteti osman e kishte shumë të vështirë t'i qëndronte përballë i vetëm një armiku të tillë dhe ishte e domosdoshme të kërkonte ndihmë nga shtetet e tjera. Të gjithë këto shtete ishin kundër përçarjes së shtetit osman dhe mbronin pavarësinë dhe tërësinë territoriale të tij.

Lufta e Krimesë përfundon me nënshkrimin e Marrëveshjes së Paqes së Parisit, me fitues shtetin osman. Megjithatë, edhe pse fitues, pas luftës, fuqia e tij zbehet dhe shteti nuk arrin të shkëput varësinë ndaj shteteve të tjera.

“Britania, e cila përkrahte tërësinë territoriale të shtetit osman dhe që shteti të vazhdonte ekzistencën e tij, e pa të dobishme dhe të domosdoshme se duhet të bëjë

<sup>19</sup> Të shihet: Banka Osmane <http://www.obmuze.com/#ottoman-bankin-kurulusu-1856/kurulus> shikuar më 02.01.2020

<sup>20</sup> Përkthimi dhe përshtatja e përmbajtjes së Fermanit të Reformave, dhe burimeve tjera të cekura në gjuhën turke dhe angleze, i takojnë autores së punimit.



reforma në korniza të një fermani që do të parashihte të drejta të reja për jomyslimanët. Përndryshe, Rusia, duke marrë si pretekst ortodoksët dhe Franca katolikët, do të përziheshin në punët e brendshme të shtetit osman.”<sup>21</sup>

“Franca po ashtu përkrahte tërësinë territoriale të shtetit osman dhe konsideronte se nëse arrihet barazia ndërmjet myslimanëve dhe të krishterëve, shteti do të forcohej edhe më shumë, ndërsa gjithashtu, për këtë qëllim, propozonte të merrej parasysh modeli francez.”<sup>22</sup>

“Mbretëria Austro-Hungareze është interesante se përkrahte një ferman me reforma, mirëpo për reformat jo të merren parasysh institucionet përfundimtare, por ato të realizohen në korniza të traditës, dokeve dhe rregullave fetare osmane.”<sup>23</sup>

Gjashtë javë para mbajtjes së Kongresit të Paqes në Paris, shteti osman, për të treguar se është pjesë e bashkësisë evropiane dhe për të fituar simpatinë e tyre, Sulltan Abdulmexhiti shpall Fermanin e Reformave.



Fotografia 3. Pjesë nga ceremonia e leximit të Fermanit të Reformave

Kjo fotografi paraqet pjesë nga ceremonia e leximit të Fermanit të Reformave, në pallatin Dolmabahçe. Në këtë ceremoni, pjesëmarrës kanë qenë një numër i madh i ambasadorëve të huaj, klerikë fetarë dhe zyrtarë të lartë të kryesisë së shtetit osman.

Shtetet e bashkësisë ndërkombëtare organizohen për të përfunduar luftën ndërmjet shtetit osman dhe Rusisë. Kështu, kongresi për paqe zyrtarisht fillon më 25 shkurt në Paris. Në këtë kongres, shtete pjesëmarrëse ishin: Britania, Franca, Austro-Hungaria, Mbretëria e Sardinjes, Prusia, Rusia, dhe Perandoria Osmane. Shtetin

<sup>21</sup> Gül Bülbul, *Islahat Fermanı'nı Hazırlayan Sebepler ve Islahat Fermanı*, f. 16.

<sup>22</sup> Po aty, f. 16-17.

<sup>23</sup> Gül Bülbul, *Islahat Fermanı'nı Hazırlayan Sebepler ve Islahat Fermanı*, f. 18.

osman e përfaqësorin sadrazemi (Kryeministri) Mehmed Emin Ali Pashai, ambasadori në Paris dhe djali i Reshid Pashait (reformatorit), Mehmed Xhemil Bej.



Fotografia 4. Këtu është paraqitur një gravurë e përfaqësuesve në një prej takimeve negociuese të paqes në Paris

Pas një agjende të ngarkuar të takimeve, palët arritën të nënshkruanin Marrëveshjen e Paqes në Paris, më 30 mars 1856. Kjo marrëveshje zyrtarisht shënon përfundimin e Luftës së Krimesë.

“Marrëveshja e Paqes në Paris i mundësoi shtetit osman që në letër të bëhet anëtare e barabartë e sistemit të shteteve evropiane dhe njëkohësisht edhe të përfitojë nga e drejta evropiane. Shtetet që e nënshkruan marrëveshjen, shtetit osman i garantonin pavarësinë dhe tërësinë territoriale si pjesë të pandashme të saj.”<sup>24</sup>

## 6. PËRFUNDIM

Shteti osman ka qenë i përbërë nga një strukturë multifetare, multikombëtare dhe multikulturore, me një shtrirje gjeografike shumë të madhe, me një sistem të udhëheqjes sa të veçantë, aq edhe të ndërlikuar. Çdo tentativë për reformim të ndonjë prej strukturave, pa dyshim se nuk ka qenë i lehtë dhe i thjeshtë. Në këtë kontekst, bën pjesë edhe shpallja e Fermentit të Reformave.

Një ndër arsyt kryesore të shpalljes së këtij fermenti ishin edhe kërkesat e forcave të jashtme për qëllime gjeostrategjike.

---

<sup>24</sup> Kemal Beydilli, Paris Antlaşması, TDV İslâm Ansiklopedisi, 2007, f. 171.

Mangësia e procesit të shpalljes së fermanit është se ai u përpilua vetëm me konsulencë të autoriteteve të jashtme, kryesisht atyre evropiane, dhe jo nga autoritete te vendit, të cilat do të bënin në mënyrë më profesionale dhe më serioze ndërthurjen e parimeve dhe vlerave të shtetit osman me ato moderne. Një arsye tjetër e qorrakut nga i cili nuk arriti të dalë Fermani i Reformave është kjo, sepse revolta e pjesës konservatore të shtetit osman, si dhe amullia që shkaktoi ndërthurja joprofesionale e vlerave dhe parimeve, devijuan rrugëtimin për zbatimin e plotë dhe deri në fund të këtij fermani.

Sido që të jetë, çdo dështim nuk paraqet fundin e procesit. Nuk mund të mohohet fakti se Fermani i Reformave paraqet iniciativë shumë të rëndësishme në procesin e inkorporimit të një kushtetute në shtetin osman.

Fermani i Reformave është pjesë e një zinxhiri dokumentesh që i paraprijnë kushtetutës. Ky ferman është dokumenti i parë që parasheh ndryshime rrënjësore në aspektin si liria e ndërrimit të fesë, përbërja e përzier e gjykatave (myslimanë dhe jomyslimanë) dhe themelimi i Bankës Osmane.

## LITERATURA

Aral, Berdal, *The Idea of Human Rights as Perceived in the Ottoman Empire*, **The Johns Hopkins University Press**, 2004.

Bianchi, T. X., *Charte Imperiale Ottomane*, Original from **University of Wisconsin** (Digitized by GOOGLE), Paris, 1856.

Berkes, Niyazi, **Türkiye'de Çağdaşlaşma**, Yapı Kredi Yayınları 16. Baskı, İstanbul, 2011.

Balci, Muharrem, *Tanzimat'tan Günümüze*, 20 Mayıs, 2000.

Beydilli, Kemal, *Paris Antlaşması*, **TDV İslâm Ansiklopedisi**, 2007.

Bülbül, Gül, *Islahat Fermanı'nı Hazırlayan Sebepler ve Islahat Fermanı*.

Erdem, Gazi, *Islahât Fermânı'na Yeniden Bir Bakış*, **Ankara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi**.

Gümüş, Musa, **Anayasal Meşrûfî Yönetime Medhal: 1856 Islahat Fermanı'nın Tam Metin İncelemesi**, 2008.

Ibrahimi, Nexhat, **Leksikoni Islam**, Logos-A, Shkup, 2012.

Ortaylı, İlber, **Shekulli më i gjatë i Perandorisë**, Logos-A, Shkup, 2010

Arkivi Shtetëror i Kryeministrisë së Republikës së Turqisë

"Osmanlı Fermanları" Numri i botimit: 63, Ankara, 2003, s.351.  
devletarşivleri.gov.tr\osmanlı\_fermanları

Banka Osmane: <http://www.obmuze.com/#ottoman-bankin-kurulusu-1856/kurulusshikuar> më 02.01.2020.

Fjalori Online i Kembrixhit

<https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/chartershikuar> më 10.12.2019

Türk Dil Kurumu: <https://sozluk.gov.tr/?kelime=TANZ%C4%B0MAT> shikuar 15.11.2019

## II. MAHMUD DÖNEMİNDE RUMELİ'YE GÖNDERİLEN FERMANLAR: KOSOVA VE MANASTIR ÖRNEĞİ

Hanife Etem<sup>1</sup>

**Özet:** *Çalışma Osmanlı evrak anlayışını esas alarak 19. yy'da yenilikleri önemseyen II. Mahmud'un Osmanlı Rumeli bölgesindeki Kosova ve Manastır vilayetlerine gönderdiği fermanların bölgeyi hangi yönlerde etkilediği irdelenmiştir. Bu araştırmada bölgeye gönderilen fermanların içerik analizi yapılmaya çalışılmıştır.*

**Anahtar kelimeler:** II. Mahmud, fermanlar, Rumeli, Kosova, Manastır.

### 1. Giriş

Osmanlı İmparatorluğu kuruluşundan yükselişine dek devletin, hukuk anlayışının adalet üretmesini önemsemiş ve temelini adalet üzerine kurmaya çalışmıştır. Bu durum, Osmanlı Devleti'nin birçok buhranlı dönem yaşamasına rağmen bu esaslardan uzaklaşmamayı ortaya çıkarmıştır. 18. yy ile birlikte Avrupa merkezli devlet-toplum-ekonomi anlayışında yeni durum kendisini etkilemiş ve şekillendirmeye başlamıştır. Modernleşme olarak adlandırılan bu süreç Osmanlı'nın klasik anlayış ve kurumlarında, değişimi ve yenilenmeyi gündeme getirmiştir. 19. yy başlarında II. Mahmud dönemi Osmanlı devletinin kadim geçmişiyle kırılmayı ve devletin yeni duruma göre yeniliklere giriştiği dönem olarak ifade edilebilir. Bu çerçevede, II. Mahmud zamanında yapılan reformların Rumeli bölgesindeki Kosova ve Manastır vilayetlerine nasıl yansıdığı, hangi konuların öne çıktığı ve ne kadar etkili olduğu konumuzun temel sorusudur. II. Mahmud tarafından bölgeye gönderilen fermanlar üzerinden tartıştığımız konumuzun temel malzemesi Kuzey Makedonya devlet arşivinde bulunan fermanlardır.

Kosova ve Manastır'a gönderilen fermanlar idari, dini, iktisadi, sosyal hayat ve imar kategorileri çerçevesinde irdelenerek içerikleri analiz edilmiştir.

---

<sup>1</sup> Az. Kiril ve Metodi Üniversitesi'nde 'I. Justinyan' Fakültesi'nde Hukuk Öğrencisi.

## 2. OSMANLI DÖNEMİNDEKİ EVRAKLAR VE EVRAK ANLAYIŞI

Hukuk alanında sistematikliğin ve belirlenmiş bir düzenin dolaşımını sağlayan şey medeni hukuktaki evrak/belge anlayışıdır. Bildiğimiz üzere evrakların farklı kategorilere ve çeşitlere ayırdığımız gibi bu durum Osmanlı zamanında da farklı bölümlerde ve amaçlarda kullanılmıştır. Osmanlı zamanındaki belge çeşitleri belirli birkaç kategoriye ayrılmıştır. Bunlar *sultani* ya da *padişah* belgeleri, *devlet erkanının emir ve arz mahiyetindeki belgeler*, *merkez-taşra arası belgeler*, *şehir içi belgeler*, *daireler arası yazışmalar*, *dilekçe ve rapor mahiyetindeki belgeler* olarak ayrılmaktadır. Bu belgeler içerisinde padişah belgeleri esas alacağımız nokta olacaktır.

### 2.1 Padişah veya Sultan-i

Berat, Nâme-i Hümâyun, Ahidname-i Hümâyun, İrade-i Seniyye, Hatt-ı Hümâyun, Sebeb-i Tahrir Hükmü, Ferman gibi belgeler padişah belgeleri içerisinde yer almaktalar. **Berat** padişah tarafından yazılan, onun tuğrasını taşıyan, devlet içi alınan yazılı kararlara isim verilir. **Nâme-i Hümâyun** ise padişahların mektubat kısmında yer alır, Nâme-i Hümâyun ismini yazanın başında ve yahuta sonunda olduğundan “name” denilir, Osmanlı diplomatiğinde name kelimesiyle çokça belge bulunmaktadır. **Ahidname-i Hümâyun** ya da **Muâhede** anlaşma metni olarak da bilinmekte; Osmanlı zamanında iki devlet arasında yapılan anlaşmaların yazı şeklinde olan belgeye **Ahidname** denilir. **Hatt-ı Hümâyun** ise padişah tarafından bizzat kendi el yazısıyla yazılan belge türüne Hatt-ı humayun denilmektedir. **İrade-i Seniyye** belgesi iki türde bulunmaktadır; sözlü İrade-i Seniye padişahın sadrazam tarafından verilen sözlü emirdir, yazılı İrade-i Seniye ise özel belge türlerinde yer alır, padişahın sadrazama bildirilir. **Sebeb-i Tahrir Hükmü**<sup>2</sup> ise maliye bölümünde kullanılan padişahın tuğrasını taşıyan belgelere isim verilir.

“Osmanlı kanunu, ferman şeklinde ortaya çıkmıştır- Sultan ne buyurduysa o sultanın yasasıdır. Böylelikle sultanların, koşullar gerektirdikçe çıkardığı kurallar bütün bir kanunname oluşturmuştur”.<sup>3</sup>

**Padişah veya Sultan-i** belgelerini olarak adlandırılan belgelerin içerisinde belkide en çok kullanılan ve bilinen fermanlardır. Ferman kelime olarak Farsça’dan

<sup>2</sup> Mübahat S. Kütükoğlu, **Osmanlı Belgelerinin Dili (Diplomatik)**, TTK Yayınları, 2018, s.192

<sup>3</sup> Halil İnalcık, **Osmanlı İmparatorluğun Klasik Çağı**, Yapı Kredi Yayınları, 2016, 20. baskı, s.77

türenmiş ve anlamı da emretmek olduğu ifade edilmektedir. Osmanlı'da padişahların yazılı şekilde hükümlerini taşıyan belgelere ferman ismi verilmiştir. Ferman, Osmanlı'da farklı şekilde adlandırılmış haliyle karşılaşılabılır. Aslında fermanın yazılmış şekline göre bir sıfat verilmiştir. Örnek vermek gerekirse: *ferman-i ali-şan*, *ferman-i padişahi*, *ferman-i şerif*, *ferman-i kadr tuvan*, *kaza cereyan* gibi ve daha çok farklı isim halleriyle karşımıza çıkma durumu mümkündür. Sadece fermanın yazılması için değil tüm padişahi belgelerde belirlenmiş bir yazı şekli vardır. İçinde giriş kısmı, metin ve son bölüm ya da hatime denilen üç ana bölüme sahip olması gerekir. Bu tür padişahi belgeler resmi belgelerde yer aldıkları için yazı stil olarak Divanî yazısı kullanılmıştır.

Fermanın başlangıç kısmında başta ilk olarak padişahın tuğrası<sup>4</sup> yer alır. Her taht yönetimi sırasında bütün padişahların kişisel tuğrası olur. Tuğradan sonra padişahın ünvanı veya elkabı<sup>5</sup> anlatılır. Sonraki aşamada ise karşısında ki muhatap olunan kişinin adı veya elkabı verilmektedir. Fermanları farklı kılan şeylerden bir diğeri de belgenin giriş kısmında dua veya hayır dilekleri ile başlanmasıdır. Bu da padişahın karşıdaki kişiye saygı ve önem taşıdığını göstermektedir.

Ferman ve Berat gibi belgeler oldukça benzerdir, bazen de ayırt edilmesi oldukça zordur. İkisi de davet, tuğra, tarih, mahall-ı tahrir gibi benzerliklere sahip olduğundan dolayı aralarındaki farkı bulmak için ayrıntılara dikkat etmek gerekir.<sup>6</sup> Fermanlar emir içerir ve onların uygulanması için yazılır. Fermanlar muhatap olacak kişilere göre elkabına uygun yazılır. Bazen ise birden fazla kişilere muhatap olur. Bir diğeri fark da fermanlarda bahsi geçen olayların veya zamanın ifade edilmesidir (eğer olay geçmişte gerçekleşmişse metnin içinde olay özetlenir) ki bu farklılığı belirleyen önemli bir unsurdur.

## 2.2 Fermanlar

**Fermanlarda** giriş kısmı genellikle çok değişmez; bir kalıp şeklindedir. Giriş kısmından sonraki metinde ise ilk başta fermanın hangi amaçla ve neden yazıldığı açıklanır, sonra da erişmek istenilen nokta beyan edilir. Ondan sonraki bölümde ise padişahın nasıl bir hüküm veya emir verdiği açıklanır ve bu emir veya hüküm

<sup>4</sup> Damga, nişan.

<sup>5</sup> Elkab: kelimesi lakab anlamına gelir, kişinin ünvanı veyahut soyadları manasına gelir.

<sup>6</sup> Necdet Gök, "Osmanlı Diplomatiği Ferman ve Berat Arasında Benzerlik ve Farklılıklar", **Ankara Üniversitesi Osmanlı Tarihi Araştırma ve Uygulama Merkezi Dergisi**, Ankara Üniversitesi Osmanlı Tarihi Araştırma ve Uygulama Merkezi, 2000, S.11, s.218

gerçekleşmezse fermanında bir uyarı şeklinde tehdit, te'yid, te'kid kısmı vardır. Burada padişah gönderilen emrin uyarlanması için baskın ve sert ifadeler kullanır. Son kısımdaysa fermanın yazıldığı tarih, yer ve padişahın mührü olur.<sup>7</sup>

Bazı fermanlar menşelerine göre iki türe ayrılmıştır: *Divândan yazılan fermanlar* ve *Maliyeden yazılan fermanlar*. Böylece fermanların nereden yani kaynağının nerede olduğunu anlaşılması kolaydır.<sup>8</sup>

19. yüzyılda yukarıda saydığımız tüm bu belgeler Osmanlı hukukunda sadece Osmanlı toprakları içerisinde değil başka ülkeler arası yazışmalarda da kullanılmıştır. Günümüzde ise bu belgelerin bazısı ya kaybolmuş ya da farklı yerlerde devlet koruması altındadır (Örneğin: devlet arşivlerinde). Kuzey Makedonya'da çok sayıda Osmanlı yazıları bulunmaktadır. Bunlar belirli başlıklar altında Kuzey Makedonya Devlet Arşiv'inde korunmaktadır. *Tasnifli* ve *tasnifsiz* belgeler<sup>9</sup> olarak ayrılan bu yazıların dışında Osmanlı arşivine kazandırılan Kuzey Makedonya'daki Türk varlığıyla ilgili fotokopi, fotoğraf ve mikrofilmler<sup>10</sup> vardır.

### 3. II. Mahmud Döneminde Osmanlı ve Balkanlar

II. Mahmud tahta çıktığından beri Osmanlı Devleti'nin modern dünyaya ilk adımlarını attıran kişidir. Bu yüzden bazılarının göre modern, yenilikçi bir padişah, bazılarının göre de bu Batı'ya benzeme durumundan ziyade Gavur Padişah da nitelendirilmiştir.<sup>11</sup>

17. yy'da ayanların güç kazanmasıyla beraber ayanlar hem ekonomik-askeri hem de otoriter güç olarak büyüyorlardı. Bu büyümenin sebeplerinden biri tımar sisteminin bozulmaya başlaması aynı zamanda da köylülerden vergi toplanması sonucu ayanların ekonomik olarak büyümelerini sağlamıştır. Bu ekonomik artış özellikle Rumeli bölgesinde yoğundu. Ayanların bu artışıyla II. Mahmud Sened-i İttifak anlaşmasını ayanlar ile kabul etmek zorunda kalmıştır. Bu anlaşma, Osmanlı tarihi açısından önemli dönemeçlerden biri sayılmaktadır. Merkezi otoritenin sahip

<sup>7</sup> Kütükoğlu, a.g.e., s. 109

<sup>8</sup> Kütükoğlu, a.g.e., s.99

<sup>9</sup> Orhan Sakın-Uğurhan Demirbaş, **Makedonya'daki Osmanlı Evrakı**, T.C. Başbakanlık Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü, Ankara,1996, Yayın no.29, s.21

<sup>10</sup> Orhan Sakın-Uğurhan Demirbaş, a.g.e.,s.71

<sup>11</sup> Arif Olgun Közleme, "Burhanların Gölgesinde III.Selim ve II Mahmud Dönemi Modernleşme Girişimleri", **Toplum Bilimleri Dergisi**, 2018, s.49



olduğu gücün paylaşılması anlamını taşıyan Sened-i İttifak bazı araştırmacılara göre Osmanlı'nın Magna Charta'sı olarak nitelendirilir. Anlaşmaya göre, Anadolu ve Rumeli'nin bazı bölgeleri özerklik elde etmiştir.<sup>12</sup>

Yapılan ilk yeniliklerden biri olan Sened-i İttifak'ın dışında modernleşme sürecinde diğer önemli reformlardan bir diğeri askeri reformlardır. Bunun için askeri eğitim hazırlanmıştır. Bu eğitimde farklı bilim dallarından matematik, tıp, doğal bilimler gibi derslerle desteklenmiştir. Eğitim hayatında ise yeni enstitüler yer almaya başlar. Mekteb-i Maarif-i Adliyye, Tıp Mektebi, Mekteb-i Harbiye gibi merkezler kurulmuştur.<sup>13</sup>

Osmanlı bu yenilik sürecinde iken Balkanlar'da da durum oldukça karıştı. 19. yy'da Balkanlar'da ortaya çıkan ulusalcı hareketler bu dönemi derinden etkilemiştir.<sup>14</sup> Balkanlar'da ulusalcılık hareketi Avrupa ülkelerinden daha farklıydı. Kiliseler ile ulusalcı hareket ortak hareket etmekteydi. Rum Patrikhanesinin Balkanlar'da büyük rol oynadığı da bilinmektedir. Kuzey Makedonya'da da büyük sayıda Rum göçü olmuştur ve burada birçok kiliseler ve okullar kurmuşlardır.<sup>15</sup>

Balkanların diğer bölgelerinde ise ulusalaşmanın getirdiği isyanlar da yer alır. Bunlardan söz etmek gerekirse Sırp ve Yunan isyanları öne çıkmaktadır.<sup>16</sup>

#### 4. II. Mahmud'un Kosova ve Manastır vilayetlerine gönderdiği fermanlar

14. yy'dan 20. yy'a kadar Rumeli'de hüküm süren Osmanlı bölgede büyük bir miras bırakmıştır. Osmanlı dönemine ait birçok eser, gelenek, kültür bölgede hala yaşamaktadır. Osmanlı dönemini anlamlandırma adına Osmanlı dönemine ait belgeler birçok ülkelerin arşivlerinde bulunmaktadır. Kuzey Makedonya'da Osmanlı dönemine ait birçok belge bulunmaktadır. Konumuz açısından da ferman koleksiyonunun varlığından bahsetmek mümkündür.<sup>17</sup>

*Kuzey Makedonya Cumhuriyet Arşiv'i*nde 1646-1859 yıllar arasında birçok padişahın İbrahim Han, II. Mustafa Han, III. Mustafa, I. Abdülhamid, III. Selim, II. Mahmud, Abdülmecid, Abdülaziz, II. Abülhamid gibi padişahların Rumeliye

<sup>12</sup> İlber Ortaylı, **İmparatorluğun En Uzun Yüzyılı**, TİMAŞ Yayınları, 2017, 46 Baskı, s.20

<sup>13</sup> Ortaylı, a.g.e., s.36

<sup>14</sup> Ortaylı, a.g.e., s.40

<sup>15</sup> Ortaylı, a.g.e., s.52

<sup>16</sup> Barbara Jelavich, **Balkan Tarihi I**, Küre Yayınları, 2009, 2. Baskı, s.195

<sup>17</sup> Makedonya Devleti Cumhuriyet Arşivi, Dijital Ferman koleksiyonu, <http://www.arhiv.gov.mk/zbirka1.php>, Erişim:15.03.2019

gönderdiği fermanlar bulmamız mümkündür.<sup>18</sup> 1808-1839 yılları arasında hükümdar ve Osmanlının 30. padişahı olan II. Mahmud, bu yıllar içerisinde Kosova ve Manastır vilayetlerine gönderdiği ve günümüzde Kuzey Makedonya Devlet Arşivinde bulunan fermanları inceleyeceğiz.


Sultan II. Mahmud'un bu bölgelere gönderdiği fermanların 32 tanesi elimizde, yani arşivde bulunmaktadır. II. Mahmud hükümdarlığı döneminde Rumeliye gönderdiği fermanlar hem bölge içi meseleleri hem de Osmanlı'da yaşanan genel mevzuları içerdiğini ifade etmek mümkündür.



**Şekil 1. II Mahmud'un Kosova ve Manastır'a gönderdiği bazı fermanlar**

<sup>18</sup> M.D.C.A., <http://www.arhiv.gov.mk/zbirka1.php>

## 5. Fermanların içeriklerine göre konuları



**Şekil 2: Fermanların içeriklerine göre konular**

II. Mahmud'un Kosova ve Manastır vilayetlerine gönderdiği fermanları belirli kategorilere ayırdım: *idarî, din, imar, iktisad, sosyal hayat*. Bu kategoriler çerçevesinde vilayetlerde hangi konularda ne tür faaliyetler düzenlendiği, alınan kararların bölgeye etkileri, hangi alanlara daha çok yoğunlaştığı ve hangi alanlarda ne tür eksikliklere sahip olduğu tespit etme imkanı bulunmaktadır.

### 1. İdarî

İdare konusu altında sultan II. Mahmud'un bu iki vilayete 1808-1839 yılları arasında gönderdiği toplamda 13 adet ferman bulunmaktadır. İdarî düzenlemeleri içeren fermanlara bölgelerde, köylerde veya şehirlerde idarî yapılarındaki değişiklikler, görevli kişilerin görevden alınması/tayin edilmesi, mahallelerin kurulması gibi idari değişiklikleri kapsamaktadır.

- Sultan II. Mahmud'un bu bölgelere ilk yolladığı fermanlardan biri Hicri takvimine göre 19 Şevval 1231 - Miladi takvimine göre ise 13 Ekim 1816 de Konstantiniye'den Osmanlı yazısıyla yazılmıştır.

*“II Sultan Mahmud -- Konstantiniye fermanında Sultan buyrultusu olmaksızın II. Sultan Mahmud - Konstantiniye fermanında mahali idare tarafından sultan buyrultusu olmaksızın Pretelça'daki Aziz Yovan kilisesinin işlerine karışılmasını ve her türlü teftiş ve müşahade yapılmasını yasaklamaktadır”*.<sup>19</sup>

<sup>19</sup> M.C.D.A., Dijital Ferman Koleksiyonu, 78. ferman

- 5 Eylül 1829 yılında (1245 Rebiü'l Evvel), Konstantiniye'den gönderilen ferman ise şudur:

*“II Mahmud -- Konstantiniye fermanında İstanbul’ dan Yanina, Trikalo, Lora ve Delvina’ya kadar tüm kadılara Trikalo, Lora ve Delvina sancakları mütesarrıfı serasker Selim Mehmed Paşa’ya gönderilen bir hazine yükünün (para) korunması ve yol emniyetinin salanması için gerekli tüm tedbirlerin alınmasını emretmektedir”.*<sup>20</sup>

- 10 Mayıs 1838 (1254 Safer), Konstantiniye'den gönderilen ferman şudur:

*“II Mahmud Han -- Konstantiniye fermanında Reka kadısına yerel idarenin Debre ve Reka metropoliti Yoaninis’in Trebişte köyü ve “Aziz Yovan” manastırındaki dindaşlarını çanlarla toplamasının engellenmesini yasaklamaktadır”.*<sup>21</sup>

- 4 Ekim 1838 (1254 Safer), Konstantiniye'den gönderilen ferman şudur:

*“II Mahmud Han -- Konstantiniye fermanında Debre kadısına, Aşağı Debre’deki (Suvi Dol) tımar sahibi Hüseyin tarafından, Reka nahiyesi ile Trebişte köyünden yaz otağı vergisinin toplanmasını yasaklamasını emredilmektedir”.*<sup>22</sup>

- İdarî fermanların içinde Mülk haklarını da savunan ve bölgenin tarla ve otlaklarını korunması için fermanların da bulunduğunu bu fermanla görebilmemiz mümkündür.

*II Mahmud -- Konstantiniye fermanında Rumeli eyaleti mutasarrıfı Arif Paşa’ya, Lerin Naibi ve müfütüsüne ve Lerin’in ileri gelenlerine Lerinli Ahmed ile Abdullah kardeşlerin Stoyko adlı bir şahıs aleyhine Lerin köyü Surovin’deki tarla ve otlaklar hakkında davacı olduklarını bildirerek bu davanın soruşturulup kanuna uygun bir hükme balanmasını emretmektedir.*<sup>23</sup>

## 2. Din

Dini konuların merkeze alındığı fermanları ele alacak olursak, öncelikle bu bölgelerde görev yapan din görevlilerinin, görevlerinden uzaklaştırılması veya dini yapıların, özellikle kilise/manastırlara ve mülklerine yerel idarînin karışmamasına

<sup>20</sup> M.C.D.A., Dijital Ferman Koleksiyonu, 39. ferman

<sup>21</sup> M.C.D.A., Dijital Ferman Koleksiyonu, 19. ferman

<sup>22</sup> M.C.D.A., Dijital Ferman Koleksiyonu, 20. ferman

<sup>23</sup> M.C.D.A., Dijital Ferman Koleksiyonu, 47. ferman

emredildiği örnekler görülür. Osmanlı özellikle dini konular ve dini örgütlerin özerkliğine halel getirmeyecek uygulamalara dikkat etmiştir. 19. yy'da modernleşme ve ulusalcı hareketlerin yoğun olarak yaşandığı Balkanlar'da bu konuda dikkat daha da önemsenmişti. II. Mahmud'un 19. yy modernleşme döneminde Balkanlar'da bulunan farklı dini inanç gruplarına karşı hoşgörülü ve hak tanıyan uygulamalarını görmek mümkündür.

- 8 Kasım 1824 (1240 Rebiü'l Evvel), Konstantiniye'den gönderilen ferman şudur:

*“II Mahmud Han -- Konstantiniye fermanında İstanbul'dan Kırşehir'e kadar kadılara ve gümrük eminerine 1225 yılına ait kölelerin nakli yasağı hakkında Sultan emrine karşın beктаşi Seit Hacı Mehdi Baba'ya bir oğlan Kırşehir köyü Suluca'daki tekkeye götürme izni vermelerini emretmektedir.”<sup>24</sup>*

- 16 Eylül 1831 (Rebiülahir 1247), Konstantiniye'den gönderilen ferman şudur:

*“II Mahmud Han -- Konstantiniye fermanında Manastır kadısına pazar açılacak günün Pazar'dan Cumartesi'ye alınmasını tebliğ emretmektedir.”<sup>25</sup>*

- 20 Şubat 1837 (Zilkade 1252), Konstantiniye'den gönderilen ferman şudur:

*“II Mahmud -- Konstantiniye fermanında Manastır kadısına İstanbul'daki Hristiyan cemaati metropolitinin Manastır metropoliti Gerasimos'un işlerine mahali idare tarafından karşıldığını Saraya şikayet ettiğini bildirerek Sultan beratları ve kanunun hükümlerine uygun hareket edilmesini emretmektedir.”<sup>26</sup>*

- 20 Ekim 1838 (Şaban 1254), Konstantiniye'den gönderilen ferman şudur:

*“II Mahmud Han -- Konstantiniye fermanında Reka kadısına Rostuşa ve Velebirdo köylülerinin “Aziz Yovan - Bigorski” manastırın mülküne karışmalarını yasaklamasını emretmektedir.”<sup>27</sup>*

<sup>24</sup> M.C.D.A., Dijital Ferman Koleksiyonu, 9. ferman

<sup>25</sup> M.C.D.A., Dijital Ferman Koleksiyonu, 40. ferman

<sup>26</sup> M.C.D.A., Dijital Ferman Koleksiyonu, 45. ferman

<sup>27</sup> M.C.D.A., Dijital Ferman Koleksiyonu, 22. ferman

### 3. İmar

II. Mahmud döneminde Kosova ve Manastır vilayetlerini konu alan 3 fermana sahibiz. Fermanlara göre, Manastır vilayetinde bulunan Ohri, Debre, ve Manastır sancaklarında bazı onarımlara katkı sunulması ve imar faaliyetleri için bazı yasalar gönderilmiştir.

- 29 Aralık 1833 (Cemaziyelevvel 1249), Konstantiniye'den gönderilen ferman şudur:

*“II Mahmud Han -- Konstantiniye fermanında Manastır kadısına Manastır kadılığı -- Magarevo köyündeki “Aziz Dimitriya” kilisesinin onarımı için izin vermesini emretmektedir.”*<sup>28</sup>

- 20 Ekim 1838 (Şaban 1254), Konstantiniye'den gönderilen ferman şudur:

*“II Mahmud Han -- Konstantiniye fermanında Ohri kadısına Rostuşa ve Velebirdo köylülerinin manastırın mal varlığını kullanmaları ve korusundan ağaç kesmelerinin yasaklanması emredilmektedir.”*<sup>29</sup>

- 13 Temmuz 1839 (Cemaziyelevvel 1255), Konstantiniye'den gönderilen ferman şudur:

